



**UNIVERSITETI
ALDENT**

**Konferenca e
Shkencore Studentore **II**^{-të}**

26 Maj, 2017

BESONI TEK PROFESIONISTËT



Komiteti Shkencor:

Prof. Dr. Afrim Tabaku (Kryetar)
Prof. Asoc. Entela Haloci
PhD. Edlira Neza
Dr. Enkelejda Goci
Dr. Edlira Dedaj
Msc. Nineta Fino
Msc. Orges Simeon
Msc. Fregen Dedja
Msc. Mirva Hoxha
Dr. Rezarta Shkreli

Komiteti Organizues:

Dr. Enkelejda Goci
Msc. Orges Simeon
Msc. Fregen Dedja
Alba Kamberi
Eva Aliraj
Mirsada Ishmakej
Megi Mësonjësi

Design:

AVANTGARDE
graphic design & handmade

Press:

SHTËPIA BOTUESE
mediaprint

ISBN 0123456789XXX

Adresa: **Rr. e Dibrës, Nr. 235, Tek Selvia, Tiranë-Shqipëri**

Email: info@ual.edu.al

Web: www.ual.edu.al

Telefon: **04 2419036**

Celular: **(+355) 69 20 75216, 069 40 30003**

HYRJE

Pas efektit pozitiv të fituar nga edicioni i parë i Konferencës Shkencore Studentore, Universiteti ALDENT, me mbështetje të Qendrës Kërkimore Farmakoterapeutike dhe Qendrës së Shërbimit Klinik, ndërmorën edhe këtë vit iniciativën për organizimin e kësaj sipërmarrje të madhe në fushën e kërkimit shkencor gjithëpërfshirës.

Ky edicion i dytë i kësaj Konference vjen me një promovim dhe angazhim të studentëve të programeve studimore Farmaci, Stomatologji, Fizioterapi, Infermieri e Laborantë Dentarë.

Konferenca e II-të Shkencore Studentore sjell punime e studime kërkimore të studentëve tanë të udhëhequr nga stafi akademik në fushat e tyre profesionale si dhe bashkëpunime me institucionet si motra.

Kjo traditë është iniciuar, organizuar e menaxhuar nga Këshilli Shkencor i Universitetit në bashkëpunim me Senatin Studentor. Këshilli Shkencor ka promovuar kërkimin shkencor institucional dhe përfshirjen e studentëve si pjesë e rëndësishme e projekteve kërkimore.

Kjo Konferencë synon të mbledhë së bashku studentë e profesionistë të fushave mjekësore duke shërbyer si një arenë diskutimesh profesionale kërkimore.

Stafi drejtues i Universitetit ALDENT i uron punë të mbarë e suksese Konferencës së dytë Shkencore Studentore dhe vazhdimësi në edicionet e mëtejshme.

PËRMBAJTJA

A. SESIONI I SHKENCAVE FARMACEUTIKE

Një vëzhgim mbi njohuritë e studentëve shqiptarë të viteve të fundit të universiteteve mjekësore mbi farmakovigjilencën dhe raportimin e reaksioneve të padëshiruara të barnave	8
Fenoli në urinë si një biomarker i ekspozimit të popullatës ndaj benzolit	9
Vlerësim i tabletave të Vitaminës C 100 mg në tregun shqiptar	10
Disa formulime dermatologjike të ekstrakteve të specit djegës	11
Njohuritë e studentëve të fakulteteve të shkencave mjekësore mbi ligjin e pajisjeve mjekësore	12
Një studim i përgjithshëm mbi gabimet në modelin e recetave	13
Studim i ndërveprimeve bar-bar në kartelat pediatrike dhe kardiologjike të spitalit rajonal të qytetit të Beratit	14
Studim i sëmundshmërisë në zonën e Shëngjergjit	15
Vlerësim krahasues farmakopeal i disa tabletave xhenerike me qarkullim në Shqipëri	16
Siguria e tagetes patula në produktet kozmetike	17
Ndotja e ajrit the efektet shëndetësore në banorët e Krujës	18
Optimizimi i rendimentit dhe pastërtisë së aspirinës së sintetizuar me metoda kromatografike	19
Diabeti Mellitus, incidenca dhe mjekimi në rajonin e Korçës	20
Zhvillimi i rrjetit farmaceutik në Shqipëri vitet e fundit	21
Vlerësimi i përdorimit të antibiotikëve në Shërbimin Kirurgjikal të Urologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”	22

B. SESIONI I FIZIOTERAPISË DHE INFERMIERISË

Demenca dhe sëmundja Alzhajmer	24
Sindroma e Tunelit Karpal	25
Shpatulla e ngrirë, diagnostikimi dhe rehabilitimi i saj	26
Kujdesi infermieror në artritin Reumatoid Juvenil	27
Kujdesi infermieror në pacientët me Psoriasis Vulgaris	28
Kujdesi infermieror për pacientin në Hemodializë	29
Kujdesi infermieror për pacientët në Onkologjinekologji	30
Kujdesi infermieror për pacientët në Hematologji (Leukemia Sanguinem Cancer)	31
Trajtimi fizioterapeutik i pacientëve me Skoliozë	32

C. SESIONI I SHKENCAVE DENTARE

Menaxhimi i frikës dhe ankthit tek fëmijët në kabinetin dentar	34
Përshkrimi i antibiotikëve në kabinetet dentare, me fokus antibiotiko-rezistencën	35
Parodontopatitë në profesione të rënda (miniera)	36
Traumat dentare	37
Përcaktimi i gjatësisë së punës gjatë procedurave endodontike	38
Evidentimi i klasës skeletale sipas analizës së Steiner në studentët e Universitetit Aldent	39
Bruksizmi dhe trajtimi i tij protetik	40
Diagnoza e kistave odontogjen	41
Ankiloza	42
Fluori, balanca e tij në organizëm dhe përdorimi në profilaksinë e kariesit	43
Vështirësitë në komunikim gjatë trajtimit të pacientëve me aftësi të kufizuar në kabinetet dentare	44
Teknika e ngjyrosjes me furçë dhe rëndësia e saj në estetikën e punimeve full zirkon	45
Gingiviti hipertrofik si pasojë e pranisë së kavitetëve dhe mbushjeve jo korrekte (rast klinik)	46
Postura ergonomike e studentëve laborant dentar gjatë punës, lidhja midis njohurive teorike dhe praktikës	47
Një alternativë trajtimi në mbindjeshmërinë e zmallit me preparatin e tiefenfluoridit	48
Shumëllojshmëria e pastave të dhëmbëve në Shqipëri dhe përputhshmëria me efektivitetin e tyre ndaj indeve të forta dhe të buta të dhëmbëve tek pacientët adult	49



A. SESIONI I SHKENCAVE FARMACEUTIKE

Abstrakte

Një vëzhgim mbi njohuritë e studentëve shqiptarë të viteve të fundit të universiteteve mjekësore mbi farmakovigjilencën dhe raportimin e reaksioneve të padëshiruara të barnave

ELISA HODA; REXHINA BICI; VALENTINA METUSHI; PROF.DR. AFRIM TABAKU

Hyrje: Reaksionet e padëshiruara të barnave (ADRs) zakonisht hasen në praktikën ditore. Këto reaksione janë pasoja të padëshiruara të mjekimit me barna dhe përbëjnë shkaqet kryesore të sëmundshmërisë, si dhe përbëjnë një impakt të madh në resurset e shërbimit të kujdesit shëndetësor. ADR-të mund të parandalohen nëse specialistët e kujdesit shëndetësor i kushtojnë vëmendje të veçantë veçorive të efekteve të padëshiruara pas marrjes së barit nga pacienti. Pra, del si nevojë urgjente për studentët e viteve të fundit të shkollave të larta mjekësore, pajisja me parimet bazë të farmakovigjilencës dhe monitorimin e raportimin e ADR-ve.

Qëllimi i këtij vëzhgimi ka qenë të vlerësojë njohuritë dhe aftësitë e studentëve të viteve të fundit të universiteteve shtetërore dhe private me profil mjekësor, përta i përket farmakovigjilencës dhe raportimit të ADR-ve.

Materiale dhe metoda: Një vëzhgim ndërseksional u krye nga Nëntori 2016 deri në Mars 2017 në të cilin u përfshinë 349 studentë të viteve të fundit të mjekësisë, farmacisë dhe infermierisë të shkollave të larta mjekësore shtetërore dhe private, duke përdorur një pyetësor nëpërmjet të cilit u mblodhën të dhëna mbi përkufizimin e farmakovigjilencës, mbi qëllimin madhor të saj, mbi organizmin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë përgjegjëse për ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e ADR-ve, mbi vendndodhjen e qendrës ndërkombëtare të farmakovigjilencës, etj

Rezultate dhe diskutime: Rezultatet e përftuara nga ky vëzhgim treguan se kujdesi, njohuritë dhe metodat e zbatimit të farmakovigjilencës ishin më të pakta në studentët e infermierisë, krahasuar me ato të farmacisë dhe të mjekësisë, si dhe rreth gjysma e tyre mendonin se raportimi i ADR-ve duhet të jetë i detyrueshëm dhe është në dobi të pacientit.

Përfundime: Të dhënat e përftuara nga ky vëzhgim treguan se shumica e studentëve të viteve të fundit të universiteteve mjekësore kanë njohuri të pamjaftueshme përta i përket farmakovigjilencës dhe raportimit të ADR-ve. Rezultate e vëzhgimit tonë nxorën në pah pengesa ndërmjet njohurive përta i përket ADR-ve dhe farmakovigjilencës. Sipas mendimi tonë del e nevojshme që këto mangësi të trajtohen me prioritet për të patur një program të suksesshëm farmakovigjilence, si dhe një menaxhim më të mirë të pacientit në përgjithësi.

Fjalë kyçe: farmakovigjilencë, reaksione të padëshirueshme të barnave, njohuri, sjellje, pyetësor

Fenoli në urinë si një biomarker i ekspozimit të popullatës ndaj benzolit

ELDA SEFA*; **AFRIM TABAKU****

*Universiteti ALDENT

**Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike

Hyrje: Ekspozimi ndaj niveleve të ulta të benzenit mjedisor është e pamundur të evitohet për arsye të pranishme të tij në mjedis nga një numër i madh burimesh antropogjene. Njerezit që jetojnë afër qendrave të grumbullimit të hedhurinave ose afër tankeve nëntokësore të ruajtjes së karburanteve mund të ekspozohen ndaj përqendrimeve të larta potencialisht të rrezikshme të benzenit.

Biomarkerat shpesh përcaktohen si indikatorë që sinjalizojnë një ngjarje në një sistem biologjik ose mostër. Në literaturë raportohen një numër i madh biomarkerash të ekspozimit ndaj benzenit. Matjet e fenolit në urinë në mënyrë rutine kanë qenë përdorur për të monitoruar ekspozimin profesional ndaj benzenit, dhese nivelet e fenoleve në urinë korrelojnë me nivelet e ekspozimit.

Qëllimi i këtij vërtetimi ka qenë të vlerësojë ekspozimin e popullatës së rajonit të Fierit ndaj benzenit nëpërmjet grumbullimit të të dhënave të fenolit në urinën e pacientëve të shtruar në spitalin rajonal të Fierit, si një biomarker i ekspozimit

Materiale dhe metoda: Është kryer një vëzhgim retrospektiv bazuar në të dhënat e fenolit urinar të pacientëve të shtruar në spitalin rajonal të Fierit. Ne kemi mbledhur të dhëna për nivelet e fenolit në urinën e 125 pacientëve të ekspozuar ndaj benzenit në mjediset e punës dhe ato të banimit. Nga numri total i pacientëve 31 ishin banorë të qytetit të Fierit dhe 94 pacientë nga zonat naftëmbajtëse. Përcaktimi i benzenit në urinë është kryer me metodën kolorimetrike.

Rezultate dhe diskutim: Të dhënat e përftuara nga ky vëzhgim treguan se në pacientët që jetonin në qytetin e Fierit përqendrimi i fenolit në urinën 24 orëshe luhatej nga 27 deri 98 mg/24 orë urinë, ndërsa në pacientët që jetonin në zonat naftëmbajtëse përqendrimi ishte 45 – 287 mg/24 orë urinë. Nuk u konstatuan diferenca sinjifikative përse i përket përqendrimeve të fenolit në urinë.

Përfundime: Rezultatet e këtij vëzhgimi vunë në dukje se vetëm 6.4% e pacientëve nga qyteti i Fierit kishin përqendrimet në urinë brenda kufinjve të lejueshëm, ndërsa në pacientët që banonin në zonat naftëmbajtëse nivele brenda kufinjve të lejueshme u gjetën në 3.12%.

Fjalë kyçe: fenol, biomarker i ekspozimit, benzene, zonë naftëmbajtëse

Vlerësim i tabletave të Vitaminës C 100 mg në tregun shqiptar

VALBONA ALUSHI*; **MARSIDA DEMARKU***; **Dr. ENKELEJDA GOCI****

**Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti Aldent*

***Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti Aldent*

Hyrje: Acidi askorbik është një nga vitaminat e rëndësishme të tretshme në ujë. Shumë bimë dhe kafshë e sintetizojnë acidin askorbik sipas nevojave të tyre. Megjithatë, majmunët dhe humanët nuk mund ta sintetizojnë acidin askorbik në sajë të mungesës së enzimës gulonolakton oksidazë.

Njohja e vitaminës C është e lidhur me historinë e kërkimit për shkakun e një sëmundjeje të lashtë hemorragjike si skorbuti. E izoluar në 1928, vitamina C është e rëndësishme për zhvillimin dhe mbajtjen e indit lidhor. Ajo luan një rol të rëndësishëm në formimin e kockave, shërimin e plagëve dhe mbajtjen e shëndetshme të mishrave të dhëmbëve.

Përdorimi i shtuar i produkteve farmaceutike dhe natyrale që përmbajnë vitaminë C solli domosdoshmërinë e zhvillimit të procedurave të sakta dhe specifike për përcaktimin e saj.

Qëllimi i këtij studimi ka qenë vlerësimi farmakopeal i tabletave të vitaminës C që qarkullojnë në tregun shqipëtar.

Materiale dhe metoda: U përzgjedhën nga barnat e regjistruara në Republikën e Shqipërisë tableta vitamine C 100 mg. Tabletat iu nënshtruan kontrollit organoleptik, kontrollit fizik dhe atij kimik. Gjatë këtij vlerësimi tabletave iu përcaktuan pesha mesatare, qëndresa mekanike, thërmueshmëria, koha e zbërthimit, shpejtësia e tretjes si dhe përcaktim cilësor dhe sasior me Kromatografi në Shtresë të Hollë dhe jodometria.

Rezultate dhe konkluzione: Tabletat e përzgjedhura që iu nënshtruan vlerësimit nuk paraqitën ndryshime të rëndësishme duke iu referuar limiteve farmakopeale. Gjatë identifikimit cilësor në secilin rast u konfirmua prania e vitaminës C. Përcaktimi sasior me anën e jodometrisë dha vlera të lëndës vepruese në kufijtë 92 – 105% të sasisë së deklaruar për mostën A dhe vlera mbi limitet e lejuara për mostrën B.

Fjalë kyçe: tabletë, vitaminë C, kontroll fizik, kontroll organoleptik, kontroll kimik.

Disa formulime dermatologjike të ekstrakteve të specit djegës

JONA MJALTI*; **ERALDA RAMI***; **ENKELEJDA GOCI****

**Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti Aldent*

***Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti Aldent*

Hyrje: Kapsaicina është kapsaicinoidi kryesor i specave djegës, e ndjekur nga dihidrokapsaicina. Ajo është e njohur për përthithjen efikase përmes lëkurës. Kremra lokal të kapsaicinës janë përdorur për qëllime terapeutike në trajtimin e dhimbjeve periferike në patologji si artriti reumatizmal, neuropatia diabetike, osteoartriti, dhimbje muskulare, herpes, etj.

Kapsaicina, në sajë të mekanizmit të saj të veprimit, e administruar lokalisht në lëkurë, promovon një veprim antiinflamator dhe një përgjigje analgjezike për shkak të desensibilizimit të neuroneve ndijore, të shkaktuara nga çlirimi i substancës P.

Qëllimi i këtij studimi është formulimi i disa përgatesave topike të ekstrakteve alkoolike të specit djegës në baza të ndryshme.

Materiale dhe metoda: U përzgjedhën nga tregu specat djegës të specit Capsicum frutescens, të identifikuar nga departamenti i Botanikës FSHN. Droga bimë mjekësore iu nënshtrua kërkesave farmakopeale mbi përmbajtjen e lagështisë dhe hirit. Ekstrakti i përftuar me anën e macerimit u trupëzua në baza hidrofiliqe të polimerëve makromolekularë dhe në baza lipofile.

Përgatesat e përftuara iu nënshtruan vlerësimit të kontrollit organoleptik, kontrollit reologjik, përcaktimit të pH dhe identifikimit të kapsaicinës.

Rezultate dhe konkluzione: Droga e marrë për studim i plotësonte kërkesat farmakopeale në lidhje me përqindjen e lejuar të lagështisë dhe përmbajtjes së hirit total. Përgatesat e formuluar paraqitën karakteristika të mira homogjeniteti, aftësi shpërhapëse të lartë dhe vlera të pH brenda limiteve të lejuara për përgatesat dermatologjike.

Fjalë kyçe: capsicum frutescens, capsaicin, ekstrakte, baza hidrofile, baza lipofile.

Njohuritë e studentëve të fakulteteve të shkencave mjekësore mbi ligjin e pajisjeve mjekësore

ALBA KAMBERI*; **RIXH MUHAMETI****; **ENKELEJDA GOCI*****; **AFRIM TABAKU*****

* Departamenti i Stomatologjisë; Fakulteti i Shkencave Dentare; Universiteti Aldent

**Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti Aldent

***Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti Aldent

Hyrje: Pajisjet mjekësore që ndodhen dhe përdoren aktualisht në sistemin shëndetësor shqiptar i përkasin kohëve dhe politikave të ndryshme. Pas viteve '90 hapja e kufijve bëri të mundur edhe futjen e një sërë pajisjesh mjekësore të reja e të panjohura më parë, kryesisht nëpërmjet donacioneve të ndryshme.

Pas një punë disa vjeçare politikbërëse më 2006 u hartua plani i Politikës Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri dhe në vitin 2014 u arrit të miratohet ligji 89/2014 mbi Pajisjet Mjekësore në Republikën e Shqipërisë.

Qëllimi i këtij studimi ishte testimi i njohurive të studentëve të shkencave mjekësore mbi këtë ligj dhe fushën e veprimit të tij.

Materiale dhe metoda: Në studim u përfshinë studentë të programeve studimore Farmaci (viti 4), Stomatologji (viti 4), Infermieri (viti 3) dhe Fizioterapi (master). Metodika e përdorur për mbledhjen e informacionit ishte hartimi i një pyetësori dhe depistimi i studentëve të Univeristetit Aldent, mbi njohuritë e tyre mbi këtë ligj. Pyetësori përmbante gjashtë rubrika me informacion bazë mbi përkufizimin e pajisjeve mjekësore, fushës së zbatimit, regjistrimit dhe inspektimit të pajisjeve mjekësore.

Rezultate dhe diskutime: Nga përpunimi statistikor i të dhënave të grumbulluara u pa që informacioni i studentëve mbi miratimin dhe funksionimin e këtij ligji ishte i madh, rreth 50% e tyre. 37% përqind e studentëve të programit studimor Farmaci kishin informacion mbi këtë ligj dhe përkatësisht 55% , 92,8% , 30% e studentëve të programit studimor Stomatologji, Fizioterapi e Infermieri.

Konkluzione: Mungesa e informacionit nga ana e studentëve të fushave të mjekësisë, profesionistë mjekësor të së nesërme, mbi ekzistencën e këtij ligji përbën domosdoshmërinë e përfshirjes së legjislacionit shqiptar në programet e studimit të tyre.

Fjalë kyçe: ligji 89/2014, pajisje mjekësore, studentë.

Një studim i përgjithshëm mbi gabimet në modelin e recetave

EVA ALIRAJ*; **MEGI MESONJESI***; **LEDIA LLAPI****; **ENTEHA HALOCI*****; **ENKELEJDA GOCI******

*Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti Aldent

** Farmaci "Ledia", Vlorë

*** Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Mjekësisë; Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

**** Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti Aldent

Hyrje: Rregullat mbi të cilat shkruhen recetat janë të paracaktuara dhe janë pjesë e studimit në programet studimore të shkencave mjekësore. Pjesë të formatit të shkrimit të recetës janë: seksioni i të dhënave të pacientit; seksioni recipe dhe pjesa e fundit të recetës ku përfshihen të dhënat e mjekut përshkrues dhe data.

Qëllimi i këtij studimi ishte depistimi rastësor i mënyrës së aplikimit të rregullave të formatit të shkrimit të recetave OTC të ekzekutuara në disa farmaci të qytetit të Vlorës.

Materiale dhe metoda: Metodika e përdorur për mbledhjen e informacionit ishte shqyrtimi i detajuar i 100 recetave OTC të grumbulluara në mënyrë rastësore nga disa farmaci të qytetit të Vlorës, të ekzekutuara gjatë tre muajve. Nga vrojtimi i çdo recete ato u kategorizuan në grupe sipas mungesës së pjesës së formatit të shkrimit të munguar.

Rezultate dhe konkluzione: Nga përpunimi statistikor i të dhënave të grumbulluara u pa që gabimet më të shpeshta ishin në mungesën e të dhënave të pacientit, rreth 90% e totalit të recetave. Në 30 % të recetave të përzgjedhura kishim mungesë të informacionit mbi të dhënat e mjekut që përshkruante mjekimin e dhënë.

Diskutime: Zbatimi i rregullave mbi shkrimin e recetave përbën një domosdoshmëri në mënjanimin e gabimeve mjekësore.

Fjalë kyçe: rregulla, formati i shkrimit, receta, gabime mjekësore.

Studim i ndërveprimeve bar-bar në kartelat pediatrike dhe kardiologjike të spitalit rajonal të qytetit të Beratit

PRANVERA SELENICA¹; BLERINA (HASHO) ÇULLAJ²; KLODIOLA DHAMO³

Hyrje: Ndërveprimet bar-bar (DDI) janë një nga faktorët që shkaktojnë probleme lidhur me përdorimin e barnave. Përgjigjia terapeutike e pritur mund të ndikohet nga prania e ndërveprimeve të barnave. Me numrin e madh të raportimeve mbi ndërveprimet e reja të barnave, ka qenë e vështirë për profesionistët shëndetësor të përditësohen vazhdimisht. Për këtë arsye, sistemet kompjuterike kanë ndihmuar identifikimin e ndërveprimeve të tilla.

Qëllimi: Të verifikohet shkalla dhe profili i mundësisë për ndërveprimeve midis barnave në recetat mjekësore të pacientëve të hospitalizuar pediatrikë dhe kardiovaskularë në Spitalin rajonal të qytetit të Beratit.

Materiali dhe metoda: Të dhënat për këtë anketë janë mbledhur duke realizuar një analizë mbi 40 kartelat mjekësore të të rriturve që vuajnë nga sëmundjet kardiovaskulare dhe të dhënat mjekësore të pacientëve në repartin e pediatrikisë, gjithsej 70 kartela, të shtruar në spital gjatë periudhës nga Dhjetori 2016 deri në Mars 2017.

Të dhënat e mbledhura për këtë studim përfshinin demografinë, dozën e barnave, dhe diagnozën e pacientit. Analiza e mundësisë për ndërveprime dhe papajtueshmëri të barnave u krye duke përdorur programin Micromedex / Drug-Reax®.

Rezultate dhe diskutime: Duke përdorur programin Micromedex në anketën tonë, ne kemi gjetur gjithsej 30 mundësi për ndërveprime të tipit bar-bar, në pacientët që vuajnë nga sëmundjet kardiovaskulare. 36.6% e këtyre ndërveprimeve ishin ndërveprime farmakodinamike, ndërsa 10% kanë treguar sinergjizëm farmakodinamik. Përsa i përket llojit të ndërveprimit, 10% e tyre ishin të tipit të moderuar, 6.6% të rënda dhe pjesa tjetër kanë rezultuar të vogla.

Në repartin e pediatrikisë janë gjetur edhe 30 ndërveprime të tipit bar-bar. 28,56% e tyre ishin farmakokinetike dhe 8.38% të tipit farmakodinamik. 4.19% e ndërveprimeve të gjetura në repartin e pediatrikisë kanë qenë të moderuara. 14.2% e tyre ka treguar sinergjizëm farmakodinamik dhe 4.7% kanë treguar papajtueshmëri farmaceutike.

Përfundime: Ne zbuluam një numër të konsiderueshëm të mundësisë për ndërveprime të tipit bar-bar në pacientët e hospitalizuar pediatrikë dhe kardiovaskularë në Spitalin Rajonal të qytetit të Beratit.

Studim i sëmundshmërisë në zonën e Shëngjergjit

FREDIANA BRAHIMI¹; BLERINA (HASHO) ÇULLAJ²; KLODIOLA DHAMO³

Hyrje: Sëmundshmëria e popullatës përbën një problem shumë të rëndësishëm shëndetësor pothuajse për të gjitha vendet. Për më tepër, shumë përkufizime dhe interpretime të këtij fenomeni janë përdorur në mënyra të ndryshme. Për shkak të rëndësisë shoqërore dhe klinike, është e rëndësishme që koncepti të jetë i qartë. Me rritjen e numrit të sëmundjeve kronike, do të ketë edhe ndryshime në pritshmërinë e rezultateve të marra nga trajtimi i sëmundjeve.. Në praktikën e përgjithshme shumë pacientë të moshuar vuajnë nga më shumë se një sëmundje kronike

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të përshkruajmë shkallën e sëmundshmërisë në zonën e Shëngjergjit në Tiranë.

Materiale dhe metoda: Ne kemi kryer një studim nga 100 kartela mjekësore të marra prej totalit të kartelave si edhe kemi studiuar 196 të dhëna të ekzaminimeve të check up. Analiza e shpërndarjes dhe përqindjes së çdo sëmundje është bërë duke përdorur programin Microsoft Excel

Rezultate dhe diskutime: Duke përdorur programin Microsoft Excel në anketën tonë, nga 196 të dhëna të ekzaminimeve të check up të përgjithshëm, ne kemi gjetur gjithsej 16 sëmundje të ndryshme. Nga 100 kartela mjekësore të marra prej totalit të kartelave, ne kemi gjetur 24 sëmundjeve të ndryshme. Prevalenca e raportuar e multi-sëmundshmërisë varion nga më pak se 1% në mbi 50%, me prevalencë më të lartë në të moshuarit.

Konkluzione: Prevalenca e sëmundjeve të hasura nga studimi 196 të dhëna të ekzaminimeve të check up të përgjithshëm ishte: Diabet mellitus 1.5%, Hepatit kronik 2%, Dislipidemi 5.1%, Hipertension arteriari 3.5%, Anemi hipokrome 1.5% etj.

Prevalenca e sëmundjeve të hasura nga studimi i 100 kartelave ishte: Hipertension arteriari 10%, Bronkiti asmatik 13%, SPOK 7%, IKK 5% Diabet mellitus 10% etj.

Multi-sëmundshmëria kufizon vlefshmërinë e rezultateve të jashtme të marra nga trajtimi i një sëmundjeje të vetme dhe komplikon organizimin e kujdesit mbi sëmundjet

Vlerësim krahasues farmakopeal i disa tabletave xhenerike me qarkullim në Shqipëri

ERA KUCI; REZARTA SHKRELI*

Departamenti Farmacisë, Fakulteti Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri

Përmbledhje: Kinolonet janë agjentë baktericide me një spektër të gjërë veprimi dhe janë efikas si ndaj baktereve gram-negative ashtu edhe ndaj atyre gram-pozitive. Kinolonet përdoren në trajtimin e infeksioneve të shkaktuara nga baktere që janë rezistente ndaj veprimit të shumë antibiotikëve. Indikacionet e kinoloneve janë në: infeksionet e traktit të poshtëm respirator, infeksionet dermike, ato te indit kockor dhe lidhor, si edhe në infeksionet e traktit urinar të shkaktuara nga: E.coli, K. pneumonia, Proteus mirabilis, Pseudomonas aeroginosa, etj. Në tregun farmaceutik shqiptar qarkullojnë një numër i madh tabletash xhenerike, ku vendin kryesor e zë ciproflaksacina, 250 mg, 500 mg dhe 750 mg.

Qëllimi i punimit ishte vlerësimi cilësoro-sasior farmakopeal i disa tabletave Ciprofloksacinë 500 mg me qarkullim në tregun farmaceutik shqiptar, sipas BP 2007.

Materiale dhe metoda: Në punimin tonë u morën për vlerësim 4 tableta xhenerike të Ciprofloksacinës 500 mg, të gjitha të veshura me cipe polimerike, si më poshtë: Test T1, Test T2, Test T3 dhe Test T4. U kryen provat e kontrollit organoleptik dhe atij fiziko-kimik: prova e zbërthimit, prova e qëndresës në këputje, uniformiteti i masës, si edhe identifikimi (nëpërmjet kromatografisë në shtresë të hollë) dhe përcaktimi sasior i ciprofloksacinës (me anë të spetroskopisë UV-VIS), sipas BP 2007.

Rezultate dhe diskutime: Tabletat e Ciprofloksacinës (T1, T2, T3 dhe T4) ishin uniforme në pamjen e jashtme dhe në prerje, njëtrajtësisht të ngjyrosura, pa njolla dhe pa pika, me buzë të rrumbullakosura. Në provën e zbërthimit të katër testet, T zbërtheheshin brenda 30 minutave. Qëndresën në këputje të përafërt me T1 e kishte mostra T4: (T1-198 N, T4-199 N), ndërsa T2 dhe T3 kishin qëndresë më të vogël (rreth 117 N). Pësha mesatare e mostrave ishte e përafërt me atë referencë, T1 (T1-787 mg, T2-779 mg, T3-768 mg dhe T4-781 mg). Në të katër testet u vërtetua prania e principit ciprofloksacinë. Analiza sasiore tregoi që mostrat T2, T3 dhe T4 përmbanin rreth 98% ciprofloksacin, ndërsa T1 përmbante 92%.

Konkluzione: Të dhënat krahasuese cilësore dhe sasiore për mostrat T2, T3 dhe T4 kishin ndryshime referuar T1, por katër tabletat xhenerike (T1, T2, T3 dhe T4) vërtetojnë vlefshmërinë farmakopeale të këtyre formë-dozave për përdorim në tregun farmaceutik.

Fjalë kyçe: tableta xhenerike, limite farmakopeale, vlerësim cilësoro-sasior, ciprofloksacin 500 mg.

Siguria e tagetes patula në produktet kozmetike

ERA MEMINAJ; EDLIRA NEZA

Përmbledhje: Bimët e familjes Compositae (Asteraceae) janë ndër arsyet kryesore të shfaqjes së dermatit të kontaktit në Europë. Seskuiterpene laktonike janë alergjenet më të rëndësishëm në familjen Asteraceae. Disa studime sugjerojnë se faktorë alergjik janë edhe kumarinat, seskuiterpene alkolike dhe tiofenet. *Tagetes patula* L. (Asteraceae) është një bimë e njohur me një spekter të gjerë veprimesh terapeutike të lidhura me praninë e tiofeneve por gjithashtu të benzofuraneve, karotenoideve dhe flavonoideve. Bima ka veprim antibakterial, antifungal, antiviral dhe insekticid. Në produktet kozmetike *T.patula* është përdorur për vetitë antioksiduese si dhe në produktet kundër rrudhave. Vaji esencial i *T.patula* është gjithashtu një përbërës i parfumeve në kozmetike. Përbërësit kryesor të ekstrakteve/vajrave të *T.patula* janë limoneni, (E)- β -ocimine, β -felandren, p-cymen, β -kariofilen. Qëllimi i këtij punimi është vlerësimi i sigurisë së *T.patula* në produktet kozmetike bazuar në artikujt e publikuar si dhe opinionet e SCCS (Scientific Committee on Consumer Safety) mbi sigurinë e *T.patula* në produktet kozmetike.

Materiale dhe metoda: Kërkimi në Pubmed është bërë duke përdorur fjalët kyçe: "*T.patula and cosmetics*", "*T.patula and contact dermatitis*", "*T.patula and phototoxicity*", "*T.patula and safety*".

Rezultate: Në 81 artikuj të shqyrtuar janë regjistruar raste me dermatit kontakti të shkaktuara nga seskuiterpene laktonike të pranishme në *T.patula*. *T.patula* përmban një substancë fototoksike dhe alergjike e quajtur α -tertienil. Limoneni është një tjetër komponim i vajit esencial të kësaj bime me veti të njohura alergjike.

Konkluzione: Frekuenca e reaksioneve alergjike është e ulët për *T.patula* në produktet kozmetike ndërsa më e lartë është frekuenca e fototoksicitetit. SCCS konsideron përqëndrimin maksimal 0.01% të ekstrakteve dhe vajrave esencial të *T.patula* në produktet që qëndrojnë në lëkurë (me përjashtim të produkteve kozmetike kundër diellit) të sigurta nese përmbajtja e alfa tertienilit të mos kalojë 0.35%.

Ndotja e ajrit the efektet shëndetësore në banorët e Krujës

ARDIT PASHA; EDLIRA NEZA

Përmbledhje: Ndotja e ajrit kontribuon në mortalitet dhe morbiditet. Ndotja e ajrit ka efekte akute dhe kronike në shëndetin e njerëzve, duke prekur sisteme dhe organe të ndryshme. Efektet mund të jenë që nga irritime të rrugëve të sipërme respiratore deri në efekte kronike respiratore, sëmundje të zemrës, kancer të mëlçisë, infeksione respiratore akute tek fëmijët dhe bronkite kronike tek të rriturit ose atake astmatike. Sipas studimeve këto efekte vërehen edhe në nivele të ulëta të ekspozimit. Burimet kryesore të ndotësve në rrethin e Krujës janë fabrikat e çimentos, gropat e gëlqeres dhe automjetet. Ndotësit e ajrit si, monoksidi i karbonit, dioksidi i squfurit, oksidi i azotit, ozoni, pluhuri i respirueshem janë disa nga ndotësit problematikë të ambientit. Objektivi i këtij studimi është vlerësimi i ndotësve kryesorë të ajrit në zonën e Krujës dhe vlerësimi i frekuencës së shtrimeve spitalore nga 2010 deri 2017 veçanërisht me sëmundje respiratore në Spitalin Rajonal të zonës.

Materiale dhe metoda: Janë shfrytëzuar analizat e mbi ndotësit e ajrit të bëra nga Instituti i Studimeve Ambientale për zonën e Krujës si dhe shtrimet spitalore në spitalin e zonës nga 2010 deri me 2017.

Rezultate: Sipas analizave të ajrit në zonën e Krujës, të Institutit të Studimeve Ambientale përqendrimi i ndotësve të ajrit NO_2 , SO_2 , O_3 është dy herë më i lartë se vlerat e lejuara. Nga studimi i 410 rasteve të shtrimeve spitalore në Spitalin Rajonal të Krujës doli se rastet më të shumta ishin me pacientë që vuanin nga sëmundje respiratore si: Sëmundje Pulmonare Obstruktive Kronike (SPOK) e ndjekur nga, astma bronkiale dhe bronkiti kronik.

Konkluzione: Si konkluzion mund të themi se vihet re një rritje e konsiderueshme e shtrimeve spitalore veçanërisht pas 2010. Gjithashtu numri i pacientëve me sëmundje respiratore është dyfishuar gjatë kësaj kohe. Moshë mesatare e pacientëve është ulur.

Optimizimi i rendimentit dhe pastërtisë së aspirinës së sintetizuar me metoda kromatografike

E.HALOCI¹; E.GOCI²; R.SHKRELI²; V.TOSKA¹

¹Universiteti Mjekësisë, Tiranë, Departamenti i Farmacisë

²Universiteti Aldent, Shqipëri, Fakulteti i Farmacisë

Studente E.Metallari

Hyrje: Historiku dhe zbulimi i efekteve analgjezike të aspirinës është e lashtë dhe përmendet që nga mjeku i shquar grek Hipokrati në lidhje me përdorimin e salicinës (përbërës natyror i Salix Alba), gjatë sintezës së acidit salicilik nga shkencëtarët gjerman në 1832 dhe më pas sintezës së aspirinës (acidi acetilsalicilik) prej këtij acidi nga Felix Hoffman në qytetin e Bayerit. Analgjeziku periferik mori përdorim të gjerë edhe në veprimin antitrombocitar. Gjatë sintezës së aspirinës problematikat që ndeshen sot janë:

- mbetja e acidit salicilik e cila konsiderohet si shkaku kryesor i papastërtive për përgatitjen e tabletës dhe konsumimin e saj,
- problemi i rendimentit të këtij reaksioni.

Ky studim ka objektiv të realizojë procesin e sintezës e aspirinës me efikasitet dhe pastërti të lartë.

Metoda: Në këtë studim u ndryshuan disa nga parametrat e protokollit të sintezës së aspirinës siç janë temperatura e mjedisit, përzierja me përzierës magnetik, ulja e sasisë e ujit gjatë shpëlarjes së kristaleve të përfutur si dhe duke realizuar procesin e rikritalizimit të produktit të sintezës fillestare të aspirinës deri në 4 herë. Identifikimi dhe përçakemi sasior i produktit të formuar u realizua me anë të kromatografisë në shtresë të hollë dhe me anë të metodës së volumetrisë.

Rezultate: Gjatë zhvillimit të punës rezultoi se rifitimi i produktit ishte në nivele rreth 80-90% Duke kombinuar protokolle këto të sintezës së aspirinës u arrit optimizimi i këtij procesi deri në 90% produkt të pastër.

Konkluzione: Përmirësimi i metodikës rezultoi më eficiente në sintezën e aspirinës. Me gjithë natyrën e thjeshtë të reaksionit të esterifikimit të aspirinës ka akoma mundësi dhe mënyra për të optimizuar rendimentin dhe pastërtinë e aspirinës së sintetizuar.

Fjalë kyçe: aspirinë, optimizim, sintezë.

Referenca:

Bayer HealthCare LLC. (2008). The History of Aspirin. Retrieved April 4, 2008

General Chemical. (2003). Material Safety Data Sheet Sulfuric Acid. Retrieved April 5, 2008

Sciencelab.com. (2005). Material Safety Data Sheet Methyl salicylate MSDS. Retrieved April 5, 2008

Diabeti Mellitus, incidenca dhe mjekimi në rajonin e Korçës

E.HALOCI¹; E.GOCI²; R.SHKRELI²; S.BOZO³

¹Universiteti Mjekësisë, Tiranë, Departamenti i Farmacisë

²Universiteti "Aldent", Shqipëri

²Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë", Shqipëri
Studenti Theodhora Košta

Hyrje: Vitet e fundit vihet re një incidencë e lartë e shfaqjes së diabetit mellitus. Mosushqyerja në mënyrën e duhur, obeziteti, mbipesha, ushqimet hormonale, jeta sedentare, mendohet të jenë faktorët e riskut. Rritja dialektikëve reflektohet edhe në listën e medikamenteve të rimbursuara si edhe në koston financiare të kësaj kategorie. OBSH në raportin global të vitit 2016 thekson se kostoja vjetore e botërore e diabetit shkon në 827 billion \$. Për të vlerësuar situatën u mor në studim konsumi i antidiabetike të rimbursuar në tre vitet e fundit në rajonin e Korçës. Paralelisht u realizua një pyetësor tip për pacientët diabetik që paraqiteshin në rrjetin farmaceutik për të hulumtuar disa nga faktorët e riskut.

Metoda: Në këtë studim u përdor metodika e studimit retrospektive për tre vitet e fundit si dhe u kombinuan me zbatimin dhe përpunimin e rezultateve të një pyetësori të zbatuar në këtë rajon.

Rezultate: Nga të dhënat e konsumit të rimbursimit në rajonin e Korçës rezultoi se numri i diabetikëve që përfitonin rimbursim ishte rreth 6000 pacientë në vit, me një shtesë prej 720 pacientë në periudhën 2014-2016 me vlerë mesatare rimbursimi rreth 106 mln lekë nga të cilat 80% insulina, 10% metformina, 5% glibenklamidi të vlerës totale. Nga pyetësorët rezultuan se nga 70 pacientë pyetur mars-prill 2017 (30-80 vjeç) u vu re se 40% të tyre kishin pasur historik familjar të sëmundje si dhe kishin një periudhë mjekimi prej mesatarisht 15 vjet.

Konkluzion: Shihet një rritje të numrit të pacientëve në vitet e fundit, paralelisht konsumi i lartë i barnave antidiabetike gjë që shoqërohet me një rritje të koston të mjekimit. Gjithashtu në grupin e pacientëve të pyetur vihet re një përqindje e lartë e faktorit trashëgimisë, obeziteti si dhe duhanpirjes. Kjo situatë çon në domosdoshmërinë ndërgjegjësimit të popullatës për faktorët e riskut si dhe monitorimit e kësaj patologjie.

Fjalë kyçe: diabetes mellitus, konsum, antidiabetikë.

Referenca:

World Health Organization: Diabetes Mellitus: Report of a WHO Study Group. Feb 2016

DRSKSH Korçë

Zhvillimi i rrjetit farmaceutik në Shqipëri vitet e fundit

E.HALOCI¹; E.GOCI²; E.MUSTAJ²; AFRIM TABAKU²

¹Universiteti Mjekësisë, Tiranë, Departamenti i Farmacisë

²Universiteti "Aldent", Shqipëri

²Studenti Jesmina Kalushi

Hyrje: Rrjeti farmaceutik në Shqipëri ka pasur dinamikën e vetë të zhvillimit duke filluar me farmacitë e hapura nga të diplomuarit jashtë, me hapjen e shkollave dhe degëve universitare dhe me pas liberalizimin e pronësisë, hapjes si dhe shtimin e numri të diplomuarve. Ky studim është bërë me qëllim për të dhënë një panoramë të përgjithshme ndër vite të rritjes dhe zhvillimit të rrjetit farmaceutik siç janë farmacitë dhe depot farmaceutike.

Metoda: Në këtë studim u përdor metodika e studimit retrospektive si dhe mbledhje të dhënash nga artikuj, faqja zyrtare e Urdhrit të Farmacistit si dhe ajo e Qendrës Kombëtare të Licensimit.

Rezultate: Nga të dhënat rezultoi se numri i farmacive ka ardhur në rritje ku numrin më të lartë e ka rrethi i Tiranës, Durrësit, Elbasanit etj., rritje të numrit të farmacistëve të licensuar pas viteve 1995, i cili aktualisht shkon në 2459. Numri i depove farmaceutike pas një rritje të shpejtë në vitet 1999-2006 aktualisht për shkak të ndryshimeve ligjore si dhe marzhit të fitimit të tyre vihet re ulje e numrit të tyre.

Konkluzion: Liberalizimi i hapjes së farmacive, heqja e kushtit të largësisë, rritja e të diplomuarve si pasojë e arsimit privat shpjegojnë rritjen e numrit të farmacive dhe të licensuarve. Ndërkohë që në 2-3 vitet e fundit si pasojë uljes së marzhit por edhe hapjes së palimituar kanë bërë që të kemi një rënie në hapjen e depove farmaceutike por edhe të farmacive.

Fjalë kyçe: farmaci, depo farmaceutike, histori.

Referenca:

<http://www.qkr.gov.al/kerko/kerko-në-regjistrin-tregtar/kerko-për-subjekt/>

<http://www.ufsh.org.al/home>

Vlerësimi i përdorimit të antibiotikëve në Shërbimin Kirurgjikal të Urologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

SILVI BOZO¹, ARJAN HARXHIZ

¹Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, Tiranë, Shqipëri

²Shërbimi i Sëmundjeve infektive, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Shqipëri

Hyrje: Profilaksia me antibiotikë në kushte spitalore përdoret për të minimizuar komplikacionet si pasojë e ndërhyrjeve kirurgjikale. Përdorimi i shumtë i antibiotikëve mund të sjellë rreziqe si shfaqja e efekteve anësore dhe zhvillimi i rezistencës antimikrobike. Për pasojë përdorimi dhe zgjedhja e terapisë me antibiotikë duhet konsideruar me kujdes dhe duhet mbështetur mbi evidenca të qarta. Në këtë studim, u mblodhën, u përpunuan dhe u paraqitën të dhënat e disponueshme mbi terapinë me antibiotikë të përdorur në shërbimin urologjik për të vlerësuar tendencat e përshkrimit të antibiotikëve si profilaksi kirurgjikale

Materiale dhe metoda: Për të vlerësuar përdorimin e antibiotikëve, u zhvillua një Studim Pikësor Prevalence (Point Prevalence Survey, PPS) gjatë muajit Maj 2017, në Shërbimin Kirurgjikal të Urologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë, Shqipëri. Të dhënat e të gjithë pacientët të shtruar në repart, në ditën e studimit u konsideruan dhe u vlerësuan. Për të vlerësuar nëse terapia ishte e përshtatshme, u përdorën protokollet ndërkombëtare të disponueshme.

Rezultate: 38 pacientë u përfshinë në studim. Prej tyre, 84.2% ishin meshkuj. Moshë e pacientëve përfshihet në intervalin 18-85 vjeç me një mesatare të moshës 63.7 ± 17.4 vjeç. Të gjithë pacientët ishin në terapi me antibiotikë, pavarësisht nga lloji i ndërhyrjes së kryer. Pjesa më e madhe e pacientëve, 63.7%, ishin në terapi me antibiotikë post-operative. Cafazolina ishte antibiotiku më i përdorur (47.2%) i ndjekur nga Gentamicina dhe Levofloxacina të përdorura respektivisht në 13.2% të rasteve. Indikimi për këtë terapi ishte paraqitur në shënimet e mjekut në 39.3 % të rasteve.

Konkluzioni: Përdorimi racional i terapisë me antibiotikë është ende një sfidë në kushte spitalore më një përdorim të shtuar të tyre si profilaksi, pa një indikim dhe arsye të qartë. Monitorimi periodik i konsumit të antibiotikëve dhe hartimi i protokolleve kombëtare është i nevojshëm për të frenuar fenomenin serioz të rezistencës bakteriale ashtu sikurse shpenzimet nga kjo klasë barnash.

Fjalë kyçe: antibiotikë, indikim, prevalencë.

B. SESIONI I FIZIOTERAPISË DHE INFERMIERISË

Abstrakte

Demenca dhe sëmundja Alzhajmer

JUXHIN THANASI; ELSID SULAJ

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent

Hyrje: Alzhajmeri shkakton probleme me memorien, të menduarit dhe sjelljen. Në fazat fillestare, simptomat e demencës janë minimale, por sa me shume sëmundja prek trurin aq me progresive behën dhe simptomat. Nën shërbimin e Fizio-Vizion drejtuar nga MSC Juxhin Thanasi janë trajtuar në kushte shtëpie 12 individë të cilët vuanin nga Alzhajmeri prej disa vitesh. Renditja e progresivitetit të sëmundjes është e ndryshme në njerëz të ndryshëm, por përgjithësisht, individët me Alzhajmer mund të jetojnë deri në 8 vjet që nga fillimi i sëmundjes. Ndërkohë që aktualisht nuk është gjetur asnjë trajtim që ndalon progresin e sëmundjes së Alzhajmerit, ekzistojnë medikamente dhe metoda që trajtojnë simptomat e demencës. Në 3 dekadat e kaluara, studiuesit kane kuptuar dhe vërtetuar se si Alzhajmeri prek trurin. Sot, studiuesit vazhdojnë ende të kërkojnë për një kurë që trajton, shëron, parandalon Alzhajmerin dhe përmirëson shëndetin e trurit.

Metoda: Metoda e aplikuar në këtë studim është deskriptive si dhe analitike ku informacioni është marrë në literaturat shkencore të cilat i kemi asimiluar gjatë procesit mësimor.

Rezultate: U vu re se personat të cilët frekuentuan seancat e fizioterapisë më shpesh ishin shumë herë më të mirëmbajtur fizikisht dhe mendërisht se sa ata që e frekuentuan rrallë fizioterapinë.

Pacientët që ndiqeshin me shërbime të tjera mjekësore si logopedi dhe ergoterapi kanë avantazhe më të mëdha në pjesën e motorikës dhe ruajtjen nga dëmtime të tjera të mundshme.

Konkluzione: Me shumë mundësi është Alzhajmer – nëse testet dhe ekzaminimet përputhen me kriteret e diagnostikimit të Alzhajmerit.

Ka mundësi të jete Alzhajmer – nëse rezultatet tregojnë që pacienti ka demencë, por nuk ka simptomat tipike të AD ose ka simptoma që ngjajnë me se sëmundje tjetër ndryshe nga AD

Alzhajmeri është sëmundje terminale, dhe deri me sot nuk ka një kurë të gjetur për ta shëruar atë.

Fjalë Kyçe: shëndet, sëmundje terminale, ekzaminim, diagnostikim, fizioterapi, seancë, test, autopsi.

Sindroma e Tunelit Karpal

MEGI KOKA; FREGEN DEDJA

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent

Hyrje: Sindroma e Tunelit Karpal përbën një disabilitet që prek rreth 3.8% se popullatës. Është një nga sindromat më të njohura neuropatike të kompromimit të nervit median në 90% të rasteve të diagnostifikuar. Sindroma e tunelit karpal shkakton një sërë simptomash që karakterizohen nga deficite neuro-motorike, si dhimbje, ndjesi mizerimi, ulje të forcës muskulore, sikurse dhe humbjen e funksionit manipulativ të dorës. Nisur nga simptomatologjia dhe numri i prekurve, i cili është gjithnjë e më shumë në rritje, qëllimi i këtij punimi është përmbledhja e sa më shumë informacioneve anatomike, simptomoatologjike, testet ortopedike dhe protokollin e trajtimit të kësaj diagnoze sipas AAOS (American Academy of Orthopedics).

Metoda: Zbatimi i protokollit ekzaminues dhe terapeutik gjatë 6-8 javë pas shfaqjes së simptomave të para, duke u bazuar në protokollin zyrtar të AAOS (American Academy of Orthopedics), i cili merret si referencë në shumë vende evropiane.

Rezultate: Një ekzaminim i saktë dhe analizë e duhur e simptomave që shfaq pacientit, që në momentet e para të shfaqjes së ndryshimeve sensomotorike të dorës, bashkëlidhur me një trajtim adekvat konservativ sjell përmirësimin e shpejtë të pacientit, duke evituar dhe ndërhyrjet kirurgjikale në regjionin e tunelit karpal.

Konkluzion: Vëmë re se sa më shpejtë të ndërhyjmë me terapi konservative, aq më efektive është prognoza dhe minimalizimi i simptomave neruologjike duke eliminuar kështu ndërhyrjet kirurgjikale në Tunelin Karpal.

Fjalë kyçe: tuneli karpal, rehabilitim, fizioterapi, nervi median.

Shpatulla e ngrirë, diagnostikimi dhe rehabilitimi i saj

ROXHENSA SULA; ONELDA GJONAJ

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent

Hyrje: Kapsuliti adeziv ose shpatulla e ngrirë janë dy terma që janë përdorur për të përshkruar një shpatull të dhimbshme dhe të ngurtë, i shkaktuar nga inflamacioni i kapsulës së shpatullës, ku indi rrethues i art.glenohumeral bëhet i skuqur dhe i ngurtë, si pasojë e kësaj kufizohet lëvizja dhe shkakton dhimbje kronike të supit. Dhimbja është zakonisht konstante, më keq gjatë natës. Arsyeja e këtij studimi është të bëjmë të ditur simptomat e kësaj patologjie, kur duhet të drejtohem tek mjeku për ekzaminimet përkatëse, roli i fizioterapistëve për rehabilitimin e kapsulitit adeziv si dhe informimin adekuat të pacientëve.

Metoda: Kapsuliti adeziv është një patologji e cila ka incidencë më të lartë tek femrat rreth moshës 40-60 vjeçare. Për të bërë një vlerësim të mirë përcaktuar të shpatullës së ngrirë duhet të njohim anatominë e artikulationit glenohumeral, strukturat kockore, indet e buta, inervimin dhe vaskularizimin. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtojmë diagnozës diferenciale që duhet të bëhet për këtë patologji në mënyrë që edhe rehabilitimi të jetë korrekt dhe efektiv. Rehabilitimi fizioterapeutik i kapsulitit adeziv ka si qëllim rikthimin e pacientit në kryerjen e aktiviteteve të jetës së përditshme.

Rezultate: Një fizioterapist i cili njeh mirë këtë patologji, ka një kontribut të madh në mobilizimin aktiv të asistuar ose pasiv të supit që lejojnë të ruhet harku i lëvizjeve.

Konkluzion: Metodat fizioterapeutike si jonoforeza, ultratingujt dhe procedura të ftohta mund të ndikojnë ndjeshëm në përmirësimin e lëvizjes artikulare dhe uljes së edemës. Fizioterapia duhet vazhduar njësoj pas të dy procedurave si ne shkrifërim(me anestezi) apo artroskopisë për të evituar riformimin e aderencave.

Fjalë kyçe: kapsuliti adeziv, simptomatika, diagnoza diferenciale, rehabilitimi.

Kujdesi infermieror në artritin Reumatoid Juvenil

ALBJONA GOÇI; MIRVA HOXHA

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent

Hyrje: Një eksperiencë familjare më shtyu të hulumtoj më tepër rreth kësaj patologjie sistemike kronike progresive e indit lidhor që manifestohet me ndryshime destruktive në artikulacione dhe ndonjëherë prek sytë dhe organet e brendshme. Artriti reumatoid juvenile është një çrregullim autoimun gjatë zhvillimit të së cilit trupi sulmon vazhdimisht disa nga qelizat dhe indet e veta. Për etiologjinë e artritit reumatoid ka pretendime të ndryshme nga studiues të ndryshëm. Kërkimet shkencore flasin për një përgjigje jo adekuate imunologjike të organizmit me antigjenin e pa definuar. Të tjerë dyshojnë tek faktorët mjedisore siç janë viruset që mund të përkeqësojnë gjendjen e fëmijëve gjenetikiisht të prekshëm.

Metoda: Paraqitje e një rasti klinik te diagnostikuar me Artrit reumatoid, kërkim në libra dhe internet, konsultim dhe seanca trajnimi me specialist të fushës.

Rezultate: Simptomat më të cilat fillon sëmundja janë: dhimbja e kyçeve, ngurtësimi mëngjesor, edema, skuqja dhe nxehtësia e lëkurës mbi artikulacione, temperature subfebrile, lodhja dhe anoreksia. Dëmtimet e artikulacioneve janë shfaqjet kryesore të AR. Në pjesën më të madhe preken disa artikulacione. Më shpesh preken artikulacionet e vogla të duarve dhe këmbëve.

Konkluzion: Së bashku me një histori të detajuar, ekzaminimin e plotë fizik dhe vlerësimin e simptomave, testet e gjakut dhe rrezet X, janë të nevojshme për të konfirmuar diagnozën. Diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi janë thelbësore për të ulur dëmin, duke mbajtur nyjat në lëvizje, muskujt e fortë dhe gjymtyrët në një pozitë të mirë.

Si rezultat i diagnostikimit dhe mjekimit të hershëm të kësaj sëmundjeje si dhe në bashkëpunim me specialistët e tjerë dhe me punë profesionale do të pretendojmë zbutjen e shenjave dhe simptomave të sëmundjes, evitimin e invaliditetit, aftësimin dhe kthimin e të sëmurëve në vendin e punës dhe në aktivitetet jetësore.

Fjalë kyçe: Artriti reumatoid, artikulacione.

Kujdesi infermieror në pacientët me Psoriasis Vulgaris

BRXHILDA MIFTARI; MIRVA HOXHA

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent

Hyrje: Psoriasis është një sëmundje lëkure që karakterizohet nga krijimi i elementeve inflamatore të ngritura në sipërfaqen e lëkurës të cilat mbulohen nga skuama (lupa) për shkak të shumëzimit hiperbolik të qelizave epiteliale. Sot në bazë të statistikave vuajnë rreth 2-3% e popullatës. Fatmirësisht në shumicën e rasteve sëmundja nuk shkakton problem me shëndetin në përgjithësi, por lokalizohet në lëkurë dhe të sëmurët shqetësohen më shumë nga ana psikologjike se ajo shëndetësore. Nëse qelizat epidermale lëvizin nga baza në sipërfaqen e lëkurës për 26 deri në 28 ditë në lëkurat me psoriasis e bëjnë për 3 deri në 4 ditë. Rreth 2% e popullsisë evropiane kanë një lëkurë psoriatike që mendohet se vjen nga një defekt hereditar i prodhimit të keratinës. Shkaku primar është i panjohur, megjithëse mendohet se kombinimi i disa faktorëve mund të ndikojnë në shfaqjen dhe agravimin e psoriazës. Traumat, infeksionet, ankthi, stresi, ndryshimet hormonale sezonale e rëndojnë situatën. Fillimi i saj paraqitet nga moshë 15 deri në 50 vjeç. Qëllimi i trajtimit konsiston në ngadalësimin e riprodhimit epidermal. Nuk ka kurë specifike.

Metoda: Prezantim i pacientit KS 54 vjeç diagnostikuar me psoriasis vulgaris dhe me lezione në të gjithë trupin.

Rezultate: Psoriasis është një sëmundje inflamatore jo infektive e lëkurës që vjen si rezultat i rritjes së qelizave epidermale 6 deri në 9 herë më shumë se norma. Qelizat në shtresën bazale ndahen shumë shpejt dhe të rejt dalin me shpejtësi në sipërfaqen e lëkurës në trajtë pllakash. Vendet më të predispozuara janë skalpi, bërrylat, gjunjët, pjesa e fundit të kurrizit, organet gjenitale.

Konkluzion: Psoriasis është një sëmundje që kurohet por nuk shërohet. Shërimi nga kjo patologji ndryshon nga pacienti në pacient. Trajtimi principal konsiston në heqjen e luspave që shoqërohet me banjë. Vajra të ndryshme shtohen në banjë dhe një furçë e butë përdoret për heqjen e luspave. Pas heqjes së luspave aplikohen kremra me përmbajtje acidi salicilik. Kujdesi infermieror konsiston në:

- Njohjen dhe shpjegimin e sëmundjes pacientit dhe familjarëve.
- Ruajtjen e integritetit të lëkurës.
- Sigurimin e imazhit trupor.
- Monitorimi dhe menaxhimi i komplikacioneve të mundshme.
- Edukimi i pacientit për vetëkujdes.

Fjalë kyçe: psoriasis vulgaris, psoriasis pustular, lëkura skuamoze.

Kujdesi infermieror për pacientin në Hemodializë

ELISA SINOMATI; MIRVA HOXHA

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent

Hyrja: Dializa është një terapi që zëvendëson pjesërisht funksionin renal dhe nevojitet atëherë kur veshkat nuk janë të afta të punojnë normalisht (insuficiencë renale), veçanërisht kur funksioni renal komprimohet deri në 85-90%. Nëse nuk aplikohet, pacienti me insuficiencë renale akumulon përveç lëngjeve edhe toksina që mund të jenë fatale për jetën. Trajtimi parashikon filtrimin e gjakut nga uji dhe substancat e refuzuara nga organizmi duke çuar në një përmirësim të mirëqenies së pacientit me çrregullime renale. Dializa, ekzaktësisht si veshkat e shëndetshme kontribuon në ruajtjen e shëndetit dhe ekuilibrit të organizmit.

Konkretisht dializa shërben për:

- Eliminimin e substancave të refuzuara nga organizmi si kriprat minerale etj., me qëllim shmangien e akumulimit të tyre në organizëm.
- Ruajtjen e ekuilibrit të substancave thelbësore të gjakut si kaliumi, sodiumi dhe bikarbonatet.
- Ndhmon për të mbajtur nën kontroll presionin e gjakut.

Aktualisht ekzistojnë dy lloj dializash: Hemodializa dhe Dializa peritoneale.

Metoda: Studim rasti klinik (pacienti MX 67 vjeç) në shërbimin e hemodializës gjatë praktikës spitalore mars 2017

Rezultate: Gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave (jo për pacienten në fjalë) që konsiderohet si një pjesë e rëndësishme e procesit infermieror konkludim se shkaqet që çojnë në një pamjaftueshmëri të punës së veshkave mund të jenë të ndryshme por që mund të lejojnë pacientin të praktikojë aktivitete të ndryshme fizike, të punojë apo studiojë si dhe të bëjë një jetë aktive jashtë orëve që i dedikon terapisë.

Konkluzion: Hemodializa është një terapi efektive që ndikon në rritjen e cilësisë së jetës së pacientit me insuficiencë renale. Edukimi shëndetësor efektiv i pacientit nga ana e personelit shëndetësor, bashkëpunimi i pacientit dhe familjarëve me personelin si dhe një kujdes infermieror adekuat çon në rritjen e jetëgjatësisë së këtyre pacientëve. Edhe pse kjo terapi duhet të kryhet çdo 3-4 ditë, pacientët mund të bëjnë një jetë aktive dhe të rregullt gjatë ditëve të tjera.

Fjalë kyçe: hemodializa, dializa peritoneale, fistula, kateterë, dezinfektant i aparatit të hemodializës.

Kujdesi infermieror për pacientët në Onkogjinekologji

OLIGERTA BECA; MIRVA HOXHA

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent

Hyrje: Kanceri i gjirit është një patologji në rritje te femrave dhe pas kancerit të mushkërive është shkaku i dytë i vdekjeve nga sëmundjet kanceroze. Incidenca e kancerit të gjirit ka ardhur duke u rritur vitet e fundit por mortaliteti nga kjo sëmundje ka ardhur duke u ulur për shkak të depistimit të hershëm dhe trajtimeve të reja dhe efektive. Etiologjia e shumicës së rasteve me kancer të gjirit është e panjohur. Si faktorë risku të njohur mund të përmendim: gjinia femër, histori familjare për kancer gjiri, menarke (menstruacione) të hershme, menopauza e vonshme, mosha e madhe e nënës në lindjen e parë, dieta e pasur me yndyrna, rrezatimi jonizues i përsëritur i regjionit të gjirit për qëllime mjekuese (mastite) ose diagnostike (mamografi dhe radiografi të shpeshta të toraksit, mutacionet gjenetike si p.sh. BRCA 1/2 etj. Kanceri i gjirit karakterizohet nga një periudhë e gjatë subklinike. Që ai të bëhet i kapshëm duhet të arrijë madhësinë së paku 1 cm.

Metoda: Studim rasti klinik (Pacientja MC. 35 vjeç) në shërbimin e Onkologjisë, repartin e Gjinekologjisë të pacientes së diagnostikuar dhe trajtuar më Ca mammae e cila u ri hospitalizua me hemoragji vaginale dhe me suspect ca ovari.

Rezultate: Pacientja në fjalë i është nënshtuar mastektomisë me zvotim të gjëndrave limfatike aksilare më 16 mars 2016 e më pas me kimioterapi. Hospitalizuar me hemorragji vaginale e shoqëruar me dhimbje pelvike, me suspect ca ovari i kryhet heqja kirurgjikale e organeve riprodhuese. Kujdesi infermieror konsistoi në trajtimin aseptik të plagës kirurgjikale, menaxhimin e dhimbjeve si dhe mbështetjen psikoemocionale.

Konkluzion: Pacientët me kancer gjiri në stadin 0 duhet ti nënshtrohen ekzaminimit fizik çdo 6 muaj për 5 vjet, e më tej çdo vit. Po kështu çdo vit duhet të realizohet edhe mamografia. Pacientet me stad I të kancerit të gjirit duhet ti nënshtrohen ekzaminimit fizik çdo 4-6 muaj për 5 vjet e më tej çdo vit. Duhet të kryejnë mamografinë çdo vit në të dy gjinjtë nëse kanë bërë kirurgji konservative dhe në gjirin e mbetur në rast se i janë nënshtuar mastektomisë. Ro-grafi pulmonari çdo 9 muaj. Gjithashtu duhet të kryejnë ekzaminimin gjinekologjik çdo 12 muaj pasi mutacionet gjenetike të p.sh. BRCA $\frac{1}{2}$ lidhen me kancerin e ovareve. Duhet të bëhet shintigrafia e skeletit çdo 1-5 vjet.

Fjalë kyçe: Mastektomi, BRCA $\frac{1}{2}$, ca ovari, mamografi.

Kujdesi infermieror për pacientët në Hematologji (Leukemia Sanguinem Cancer)

XHESIKA KAPLLANI; MIRVA HOXHA

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent

Hyrje: Leukemia është lloj i karcinomit të gjakut si rezultat i shumimit anormal, të pandalshëm dhe invaziv të qelizave malinje me origjinë hematopoetike të cilat infiltrojnë palcën kurrizore, gjakun periferik, organet dhe indet tjera. Këto 20-30 vitet e fundit ka pasur përparime në trajtimin e saj. Në lidhje me të gjitha rastet tani ekziston një jetëgjatësi më e madhe. Etiologjia e shumicës së rasteve me leukemi është e panjohur. Si faktorë rrisht të njohur mund të përmendim: faktorët gjenetik të rrishtit, ekspozimin ndaj rrezeve X dhe formave të tjera të rrishtimit (p.sh. bombat atomike), kimikatet e caktuara siç është avulli i benzol-it, pesticideve dhe infeksionet virale të caktuara, ekspozimi ndaj kimioterapisë dhe kimikateve të tjera. Fëmijët edhe të rrishtit të cilët janë duke u kuruar për kancer të tjerë janë në rrisht më të larë të shfaqjes së një kanceri të dytë. Gjithashtu, më shumë janë të prekur të rrishtit se sa fëmijët edhe më shpesh meshkujt se sa gratë.

Metoda: Studimi i rrishtit klinik (Pacientja EK. 17vjeç) në shërbimin e Sëmundjeve të Brendshme në repartin e Hematologjisë e diagnostikuar dhe trajtuar me Ca Sanguinem Leukemia e cila u hospitalizuar me epistaksis, gingivorragia edhe enjtje të fytyrës dhe krahëve.

Rezultate: Pacientja në fjalë i është nënshtruar kimioterapisë. Falë kujdesit dhe terapisë specifike është ndërprerë hemorragjia ginvale si dhe është ulur enjtja. Kujdesi infermieror konsistoi në marrjen e analizave intravenoze të gjakut, informimin e pacientes edhe familjarëve për çdo etapë të ndjekur sipas udhëzimeve të mjekut. Mbështetja psikoemocionale, qartësimi i konfuzioneve mendore ishte një fazë e rëndësishme e kujdesit.

Konkluzion: Pacientët me Leukemi duhet t'i nënshtrohen ekzaminimit fizik çdo 6 muaj për 5 vjet, e më tej çdo vit. Po kështu pacientit i jepet kimioterapi me pilula për 2-3 vjet. Medikamentet më të përdorur janë Adriamicine, Oncovin etj. Pacientja duhet të qëndrojë në kontakt me mjekun për çdo shqetësim edhe duhet të mbahet në kontroll nëpërmjet ekzaminimeve si gjak komplet, radioterapia, biopsia, punkcioni lumbar.

Fjalë kyçe: hemorragji, kimioterapi, transfuzion.

Trajtimi fizioterapeutik i pacientëve me Skoliozë

SILVIO SELFO; FREGEN DEDJA

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent

Hyrje: Skolioza është një devijim jo fiziologjik i shtyllës kurrizore në të treja planet e lëvizjes, e cila prek 2% të femrave dhe 0.5% të meshkujve. Ajo sjell ndryshime posturale të cilat ndikojnë në sistemin muskuloskeletor dhe gjithashtu në funksionin e kapacitetet pulmonale. Vitet e fundit është vënë re një rritje e ndjeshme e numrit të pacientëve të cilët janë të prekur nga kjo diagnozë, sidomos moshave të vogla ose pre adoleshente. Kjo situatë ka rritur ndjeshmërinë ndaj këtij fenomeni të prindërve, mësuesve të edukimit fizik ashtu edhe fizioterapeutve. Qëllimi i kësaj teme është informimi dhe dhënia e sa më shumë informacioneve që kanë të bëjnë me parandalimin, diagnostifikimin dhe trajtimin fizioterapeutik të pacientëve me skoliozë.

Metoda: Përmbledhje e informacioneve anatomike dhe ndryshimeve funksionale që ndodhin tek pacientët që janë diagnostifikuar me skoliozë. Informimi mbi masat parandaluese. Përshkrimi i një protokollit diagnostifikues dhe terapeutik.

Rezultate: Një fushatë sensibilizuese e prindërve dhe e mësuesve të edukimit fizik nëpër shkollat fillore apo të mesme do të ndikonte të diagnostifikimin sa më të hershëm të pacientëve me skoliozë, duke bërë në këtë mënyrë të mundur dhe përmirësimin e prognozës apo dhe uljen e rasteve të skoliozës tek moshat e vogla.

Konkluzion: Fushatat sensibilizuese ndihmojnë në parandalimin e numrit të personave të cilët preken nga skolioza. Pacientët të cilët janë të diagnostifikuar me skoliozë, iu duhet dhënë një trajtim sa më efikas rehabilitues.

Fjalë kyçe: skolioza, rehabilitim, fizioterapi.

C. SESIONI I SHKENCAVE DENTARE

Abstrakte

Menaxhimi i frikës dhe ankthit tek fëmijët në kabinetin dentar

ANIDA CUNI; XHESIKA ZHELEGU; GRETA KUPI

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Frika dentare është një nga frikat më të zakonshme tek fëmijët. Si ankthi dhe frika në kabinetet dentare çojnë në shmangien e trajtimit, kjo e fundit do të na çojë në përkeqësim të shëndetit të gojës. Fëmijët me frikë dhe fobi nga dentisti mundohen t'i shmangen vajtjes tek ky i fundit në rastet e problemeve të vogla ku mund të neglizhohet.

Qëllimi: Menaxhimi i duhur i qëndrimit të fëmijëve ndaj frikës nga dentisti ndihmon në trajtimin e duhur të sëmundshmërisë karioze, komplikacioneve të saj si dhe në kryerjen e trajtimit të duhur ortodontik.

Materiale dhe metoda: Për të pasur informacionin e duhur në studium rreth 10 literatura të ndryshme bashkëkohore. Gjithashtu në këtë rishikim literature u morën në konsiderate eksperiencat dhe studimi i organizatës DFA. Për të plotësuar studimin u morën në shqyrtim edhe një sërë studimesh të publikuara në internet përreth frikës dhe ankthit që ndjejnë fëmijët në kabinetin dentar.

Rezultate: Hulumtimi zbuloi manifestime të shumta, duke përfshirë reagimet e menjëhershme fizike (duke qarë, bërtitur), përgjigjet psikologjike (të shqetësuar, mërzitur, panik). Dëshmi nga fëmijët, adoleshentët dhe prindërit e tyre gjithashtu përvoja e dentistëve mbështetën studimet e DSA.

Konkluzione: DFA në lidhje me fëmijët dhe adoleshentët ka manifestuar shumë aspekte të cilat u bënë të dukshme vetëm nëpërmjet përdorimit të mediave sociale. Frika dentare si një ndër frikat specifike është prezent pothuajse gjithmonë në fëmijët e moshës parashkollore dhe shkollore. Zgjedhja e mënyrës së duhur të trajtimit do të sjellë shmangien e ankthit dhe frikës së fëmijëve.

Fjalë kyçe: fëmijë, ankth, frikë.

Përshkrimi i antibiotikëve në kabinetet dentare, me fokus antibiotiko-rezistencën

ILDA CUNI*; PRANVERA TAHIRI; ENXHI BODINAKU; VJOLLCA CELMANAJ; MIGENA SABAH; SUELA SKUQI; DR. BLERTA KIKA

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Antibiotikët janë një revolucion i shekullit të XX, në trajtimin e infeksioneve të ndryshme dentare dhe jo vetëm. Por përdorimi pa kriter i Antibiotikëve në ditët e sotme është një problem mbarë botëror. Në praktikën dentare sipas studimeve që janë bërë, përdorimi i antibiotikëve nuk duhet të jetë praktikë pune, përjashtojmë këtu rastet në kirurgjinë maxillo-faciale është cituar në një artikull shkencor në revistën italiane "MINERVA". Dhënia e antibiotikëve s'është automatike pasi shtimi i shtamëve rezistente ndaj antibiotikëve po sjell dështim në trajtim dhe ka një impakt të madh në situatën ekologjike.

Qëllimi: Të njohim indikacionet e përdorimit në patologjitë dentare.

Materiale dhe metoda: Në studim janë marrë rreth 10 literatura të ndryshme bashkëkohore në të cilat janë studiuar rastet e përdorimit të antibiotikëve. Gjithashtu në literature janë studiuar aspektet e antibiotiko rezistencës. Grupi i punës analizoi disa artikuj shkencorë dhe mjaft libra, revista, dhe intervista në të cilat u diskutuan dhe u studiuan antibiotikët dhe antibiotiko-rezistenca.

Konkluzione: Antibiotikët janë indikuar shpesh në praktikën dentare. Sipas studimeve është vlerësuar se 10% e të gjitha recetave të antibiotikëve janë të lidhura me infeksionet dentare. Është mjaft e rëndësishme që të gjitha dentistët të kenë parasysh që të rekomandojnë antibiotikët për përdorim nën moton: "Përdorini më pak, që të japin rezultat më mirë». Informimi dhe edukimi i pacientit ndaj higjienës personale dhe asaj buko-dentare është thelbësore në parandalimin dhe eliminimin e infeksioneve. Pacienti duhet të informohet për indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të antibiotikëve.

Fjalë kyçe: antibiotikë, drejtimi antimikrobiale, rezistenca ndaj antibiotikëve, dentistë.

Parodontopatitë në profesione të rënda (miniera)

GENTIANA KERI*; DENIS MIFTARI; SIGI HAXHIAJ; DR. EDLIRA DEDAJ

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Sëmundjet paradontale vijnë si rezultat i prishjes së balancës midis mikroorganizmave dhe organizmit të njeriut. Faktorët që ndikojnë në shfaqjen e paradontopative janë të shumtë dhe veprimi i tyre është i ndërlikuar. Të cilat ndahen në faktorë të përgjithshëm dhe lokale. Ndërveprimi i tyre është mjaft i rëndësishëm për trajtimin dhe ecurinë e sëmundjes.

Materiale dhe metoda: Subjektet i janë nënshtruar një pyetësori, i cili është shpërndarë në një grup individësh prej 100 vetash të seksit mashkull, të grupmoshës 22-55 vjeç, të ndarë në dy grupe sipas zonës ku ndodhet miniera ku ata punojnë, 50 individë në minierën e Kukësit dhe 50 individët e tjerë në minierën e Fushë Krujës. Pyetjet e referuara na informojnë mbi kushtet në të cilat kjo kategori punëtorësh punojnë, nivelin e stresit, kujdesi për higjienën orale.

Rezultate e diskutime: Për shkak të mungesës së higjienës në kavitetin oral shumë individë u paraqitën me gingiva hiperemike dhe me probleme paradontale të gjeneralizuara ose në regjione të caktuara. Këto sëmundje të kavitetit oral, ishin si rezultat të njohurive të pakta për komplikacionet që sjell mungesa e higjienës në kavitetin oral dhe organizmin në përgjithësi. Gjithashtu ndikim kishte dhe niveli i lartë i stresit, mbetjet e lëndëve kimike pas eksplozionit në brendësi të minierës, niveli i lartë i temperaturave dhe lagështirës.

Konkluzion: Është mjaft e rëndësishme të bëhet informimi i subjekteve mbi dosmosdoshmërinë e mbajtjes së një higjiene korrekte, si dhe prevenimi dhe mjekimi në kohë i paradontopative. Pas përpunimit të të dhënave të marra nga pyetësorët e strukturuar u arrit në konkluzion që të gjithë punëtorët kanë nivel të lartë stresi, mungesë të theksuar të higjienës orale dhe rëndësisë së saj.

Fjalë kyçe: ekzaminim, paradontopatitë, profesion, higjiene.

Traumata dentare

MARINELA MALÇI*; ARJOLA ALUSHI; VIONA MALOKU; DR. SHK. EDLIRA DEDAJ

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Trauma dentare nënkupton dëmtimin e dhëmbëve me ose pa përfshirje të periodontit, kockës alveolare dhe indeve të buta. Duke qenë se kemi larmi të tyre, lind nevoja e një klasifikimi sa më të thjeshtë edhe praktik për të ndërtuar një plan efikas trajtimi në një kohë sa më të shkurtër. Trauma shkakton efekte funksionale, estetike dhe psikologjike, për këtë arsye duhet të konsiderohet një emergjencë dentare.

Qëllimi: Të evidentojmë faktorët etiologjik të traumave dentare, menaxhimin e rasteve më të shpeshta klinike si dhe të informojmë mbi mënyrën sesi çdo individ duhet të veprojë përballë një traume aksidentale dentare.

Materiale dhe metoda: Janë shfrytëzuar rreth 10 (dhjetë) burime literature, revista stomatologjike, referime shkencore, website si dhe libra të ndryshme. Prezantimi i dy rasteve klinike, ku evidentohen ekzaminimet e kryera, vendosja e diagnozës dhe plani i trajtimit.

Konkluzione: Regjioni i fytyrës, kryesisht kaviteti oral shpesh bëhet targeti i traumave fizike aksidentale. Traumata dhëmbore konsiderohen si një emergjencë dentare dhe si të tilla duhet të marrin mjekim imediat sipas protokolleve të caktuara. Individët me over-jet të shprehur ose me prognati maksilare paraqesin risk më të lartë për t'u prekur nga traumata. Rol të rëndësishëm në vendosjen e diagnozës dhe ecurisë së trajtimit luan ekzaminimi radiologjik.

Fjalë kyçe: trauma, dhëmbë, faktorë etiologjik, frakturë.

Përcaktimi i gjatësisë së punës gjatë procedurave endodontike

AUTORËT: *ENDRIT HYSENAJ**; *ARJOLA SELITA*; *DR. SH. EDLIRA DEDAJ*

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Përcaktimi i gjatësisë së saktë të punës është një nga hapat më kritike në terapinë endodontike. Një përkufizim të gjatësisë së punës është: "distanca nga pika koronale e referencës deri në pikën ku duhet të mbarojë preparimi dhe obturimi i kanalit" që njihet dhe ndryshe si "stopi apikal".

Qëllimi: Të informojmë shkurtimisht mbi rëndësinë e përcaktimit të gjatësisë së kanaleve të rrënjëve, si dhe të prezantojmë metodat e ndryshme të matjes së tyre.

Materiale dhe Metoda: Në këtë studim janë marrë në shqyrtim 15 burime literature nga libra, artikuj shkencorë dhe kërkime shkencore.

Rezultate e diskutime: Gjatësi pune deficitare rezultojnë me nënmbushje dhe anasjelltas, të cilat shpesh përfundojnë trajtime të dështuara endodontike. Matësit elektronik si një risi në fushën stomatologjike, po preferohen gjithnjë e më shumë në krahasim me metodikat e tjera tradicionale (radiografite dentare etj.) duke u paraqitur me një saktësi në mbi 90% të rasteve, por duke patur dhe kjo metodë patjetër limitet e veta.

Konkluzione: Për shumë vite kanë qenë teknikat radiologjike ato që janë përdorur në mënyrë konvencionale si mjete kryesore në matjet endodontike nga mjekët stomatolog. Vitet e fundit me përparimin e studimeve mbi matjen e gjatësisë kanalare dhe me shfaqjen e matësve elektronik janë ofruar mjete më të besueshme në procedurat rutine endodontike. Është sugjeruar që një kombinim i këtyre metodave pritet të japin dhe rezultate më të suksesshme në praktikat endodontike në të ardhmen.

Fjalë kyçe: endodonti, kanal rrënje, radiografi dentare, apex locator.

Evidentimi i klasës skeletale sipas analizës së Steiner në studentët e Universitetit Aldent

XHESJANA DEDJA*; **DR. ALBA KOSHOVARI**

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Analiza cefalometrike është studimi i radiografisë së kokës me qëllim observimin e kompleksit kraniofacial.

Qëllimi: Theksimi i rëndësisë së analizës cefalometrike jo vetëm si element diagnostikues por dhe si faktor kyç në vendosjen e planit të trajtimit.

Materiale dhe metoda: Rishikim literature me anë të motorit kërkimor PubMed, i artikujve shkencorë të cilët paraqesin të dhëna të rëndësishme për benefitet e grafisë laterale të kokës në praktikën ortodontike. Studim kuantitativ në 30 studentë të universitetit Aldent, të përzgjedhur në mënyrë rastësore. Analiza cefalometrike e grafive të tyre me anë të një aplikacioni ortodontik dhe paraqitja grafike e të dhënave me anë të programit kompjuterik Excel.

Rezultate: Nga të dhënat që morëm rezulton se në 30 pacientë, 9 prej tyre i përkasin një klase të parë skeletale, 14 prej tyre një klase të dytë si dhe 7 prej tyre i përkasin një klase të tretë skeletale. Për sa i përket përcaktimit të tipit facial, nga matjet e këndit $SN^{\wedge}GoGn$ u pa që në 17 individë kemi një tip brachyfacial, në 7 prej tyre një tip dolicofacial dhe pjesa tjetër 6 individë rezultuan në normë.

Përfundime: Analiza Cefalometrike është një metodikë thelbësore për parashikimin e rritjes, parandalimin apo stabilizimin e anomalive kur ato kapen në kohën e duhur. Ndhmon në përcaktimin e klasës skeletale dhe tipit facial.

Fjalë kyçe: analiza cefalometrike, diagnozë, plani i trajtimit, klasa skeletale, tipi facial.

Bruksizmi dhe trajtimi i tij protetik

ERIKSELA HOXHA*; **IRMA SANA**; **ILDA KUQI**; **PROF. DR. RUZHDIE QAFMOLLA**

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Bruksizmi është një shtrëngim i fortë i pavetëdijshëm i dhëmbëve ditën dhe natën. Ndryshe quhet "simptoma e kërcitjes" që ndodh gjatë lëvizjes së nofullës së poshtme. Bruksizmi është një lloj parafunksioni.

Qëllimi: Të përcaktojmë shkaktarët e bruksizmit dhe mënyrat e trajtimit të tij.

Materiale dhe metoda: Për këtë studim u shfrytëzuan burime literature, libra, revista, artikuj shkencorë.

Konkluzion: Nga shqyrtimi literaturave të ndryshme rezulton se shkaktarë të bruksizmit janë stresi, parafunksionet jo okluzale, interferencat dhe parakontaktet. Vendosja e një diagnoze të saktë përcakton në mënyrë rekurente dhe mënyrën e trajtimit të bruksizmit. Ekzistojnë mënyra të ndryshme të trajtimit të bruksizmit si: Trajtimi terapeutik, trajtimi protetik, trajtimi medikamentoz, trajtimi me anë të shinave relaksuese i cili zgjat si trajtim nga tre deri në gjashtë muaj.

Fjalë kyçe: bruksizëm, diagnoza, shkaktarë, trajtim.

Diagnoza e kistave odontogjen

SIGI HAXHIAJ*; GENTIANA KERI; DENIS MIFTARI; Dr. NINETA FINO

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Kistat odontogjene janë një patologji kronike beninje. Kisti radikular është një kavitet patologjik i veshur me një saku epitelial dhe me përmbajtje likidi seroz me ngjyrë të verdhë në kafe, ku mund të ketë kristale kolesterine dhe materiale qelizore. Kistat kanë permasa nga 0.5 cm deri në përfshirje të komplet trupit të nofullës ku zhvillohen duke çuar në destruksion kockor. Kanë një zhvillim të heshtur, kjo bën që të diagnostikohen me vështirësi. Diagnoza e hershme e kistave është rezultat i ekzaminimit objektiv të kujdesshëm intra dhe ekstraoral gjatë punës në dentistri dhe observimi i kujdesshëm i radiografisë duke vlerësuar çdo detaj dhe informacion.

Qëllimi: Ritheksimi i hapave diagnostikuese për vendosjen e diagnozës dhe planifikimin e trajtimit të kistave odontogjen radikular.

Materiale dhe metoda: Ky prezantim u realizua duke punuar me literaturë vendase, ndërkombëtare dhe botime bashkëkohore. Rast klinik i një pacienti i seksit mashkull A.M 55 vjeç i komunitetit Iranian, banues në Shqipëri, i ekzaminuar klinikisht me të gjitha metodat ekzaminuese dhe me ekzaminime plotësuese, është përcaktuar diagnoza me kist odontogjen radikular.

Rezultate dhe diskutime: Rreth 60% e kistave odontogjene që hasen në maksilë dhe mandibul janë kista radikular, këto kista takohen 3 herë më shumë në maksilë sesa në mandibul dhe më shpesh në regjionin frontal maksilar. Njohja e simptomave të hershme, faktorëve predispozues dhe etiologjike e ndihmon mjekun për vendosjen e saktë të diagnozës të këtyre kistave.

Konkluzion: Një ekzaminim i kujdesshëm ndihmon në diagnostikimin e hershëm të kistave odontogjene. Diagnoza e saktë topografike, përcakton trajtimin adekuat dhe të suksesshëm.

Fjalë kyçe: kist, diagnozë, ekzaminim, maksilë, mandibul, asimptomatik.

Ankiloza

FLORINDA NOTI*; ROBERTA TEODORI; DR.SH. EDLIRA DEDAJ

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Ankiloza është bashkimi i cementit me kockën alveolare me mungesë të ligamentit periodontal. Faktorët etiologjik janë të ndryshëm: nga okluzioni, reinplantimi i dhëmbëve, inflamacionet kronike periapikale, si dhe ndryshime lokale të metabolizmit mund të shkaktojnë ankilozë të dhëmbit në disa raste. Karakterizohet si patologji e cementit që rezulton me rezorbim të rrënjës si dhe zëvendësimin e saj nga indi kockor. Kocka alveolare paraqet rezultatin e procesit të formimit dhe rezorbimin e kockës. Ky fenomen ndodh gjatë gjithë jetës. Raporti osteoblaste-osteoklase ku osteoblastet prodhojnë një matricë organike e cila, mbas një procesi kalcifikimi do të japë kockën. Ankiloza është një situatë e rrallë që më tepër e gjejmë në denticionin e përkohshëm sesa në atë të përhershëm. Më i prekuri nga dhëmbët e përkohshëm, është molari i dytë mandibular i denticionit të përkohshëm.

Qëllimi: Të evidentojmë shkaktarët e ankilozës dhe mënyrat e trajtimit për secilin nga rastet specifike, si reinplantimi i dhëmbëve, traumave nga okluzioni, si dhe inflamacioneve kronike periapikale.

Materiale dhe metoda: U shfrytëzuan 15 burime literature, libra artikuj të ndryshëm, dhe studimi i një rasti specifik klinik i cili u trajtua me ndërhyrje kirurgjikale, ortodontike me vendosjen e aparatit funksional, ruajtësit e hapësirës, dhe vendosja e implantit që rezultoi me rikthimin e të gjithë faktorëve funksional dhe estetik të pacientit.

Konkluzione: Disa nga faktorët etiologjike që mund të shkaktojnë ankilozë klasifikohen në reinplantim të dhëmbëve 14%, traumave nga okluzioni 10-15%, inflamacionet kronike periapikale 8-10%. Nga trajtimi kirurgjikal, ortodontik dhe vendosja e implantit në rastin klinik të paraqitur rezultoi zgjedhja e duhur për pacientin si në aspektin funksional dhe në atë estetik.

Fjalë kyçe: ankilozë, rezorbim, cement, kockë.

Fluori, balanca e tij në organizëm dhe përdorimi në profilaksinë e kariesit

RESUL MULLA*; ARION XHEMALI; SAMI SELIMI; DR.SH. EDLIRA DEDAJ

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Fluori është një ndër mikroelementet e sistemit periodik të “Mendelejevit”, mjaft i nevojshëm për organizmin e njeriut. I radhitur në grupin e VIII-të të halogjeneve, është një nga mikroelementet që remineralizon indet e forta të dhëmbit dhe bën parandalimin e kariesit. Mjekësia në ditët e sotme ecën me parimin: “Është më mirë ta parandalosh sëmundjen se sa ta kurosh”.

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të evidentojë dhe të përcaktojë efektet pozitive të fluorit, aplikimin dhe mënyrat e marrjes së tij, si dhe dozat e lejuara nga OBSH-ja.

Materiali dhe metoda: Për realizimin e këtij studimi janë shfrytëzuar burime literature si: libra, artikuj shkencorë, të dhëna të marra nga publikime të Shoqatës së Dentistëve Amerikanë (ADA).

Rezultate: Kalimi nga stomatologjia mjekuese në atë parandaluese është diçka e vështirë, e cila ka të bëjë me edukimin e shëndetit oral. Për të ulur sëmundshmërinë karioze dhe problematika të tjera lidhur me trajtimet duhet të përdoret fluori. Vetëm duke u bërë më të ndërgjegjshëm njerëzit, arrihet në përfitimin e rezultateve më të mira të shëndetit oral.

Konkluzione: Aplikimi i fluorit është mjaft i rëndësishëm dhe domethënës në uljen e sëmundshmërisë karioze. E rëndësishme është të dihen burimet e marrjes së fluorit dhe përdorimi i kombinuar i këtyre burimeve.

Fjalë kyçe: parandalim, fluor, burime marrjeje, doza.

Vështirësitë në komunikim gjatë trajtimit të pacientëve me aftësi të kufizuar në kabinetet dentare

GERTA KUPI; SEAD BARAKU; JONA KOÇI; MIGENA TABAKU; PAMELA KOÇEKU

Ofrimi i sigurt, i përshtatshëm dhe ekonomik i shërbimit oral, infrastruktura në tërësi e lidhur me shërbimin oral, është një faktor kyç për suksesin në komunikim në mjekësinë orale. Infrastruktura të papërshtatshme që nuk kujdesen në mënyrë të përshtatshme për nevojat e personave me aftësi të kufizuar, duke përfshirë foshnjat dhe të moshuarit, përbën një nga pengesat e sotme për një komunikim efektiv dhe premtues për një shërbim oral të suksesshëm. Për këtë qëllim sistemet dhe shërbimet në kabinetet dentare duhet të jenë të dizenuara për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe personat që kanë problem lidhur me lëvizshmërinë ose qasjen e informata. Njerëzit me aftësi të kufizuara duhet të jenë në gjendje të gëzojnë të njëjtën liri për të marrë shërbimin oral.

Pengesat që paravihen re mes problemeve të aksesit të këtij shërbimi, njerëzit me aftësi të kufizuara mund të ndikohen në çdo pjesët të rrugës, qoftë në aspektin e qasjes në informata, transportin lokal, akomodim, pjesëmarrje për lehtësira në marrjen e shërbimit oral, qoftë si spektatorë apo pjesëmarrës.

Të dhënat primare janë siguruar në kabinetet dentare në qytetin e Tiranës. Mjeti i përdorur për sigurimin e të dhënave është një pyetësor i realizuar me mjek stomatologë që zotërojnë një kabinet dentar dhe që ofrojnë shërbim stomatologjik në sektorin privat.

Përzgjedhja e kampionit është bërë në mënyrë rastësore dhe është joprobabilitare. Kampioni përbëhet prej 30 kabinetesh dentare të vendosura në qytetin e Tiranës.

Fjalë kyçe: pacientë me aftësi të kufizuar, komunikim, kabinete dentare.

Teknika e ngjyrosjes me furçë dhe rëndësia e saj në estetikën e punimeve full zirkon

DONATELA BENDAJ; KEJDI BIFSHA; MSC AJOLA NASTI

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Në vitet e fundit, dentistria estetike ka pësuar një zhvillim të vrullshëm së bashku me kërkesat e pacientëve dhe zhvillimeve inovative për materiale duke përmirësuar aftësitë profesionale në sigurimin e trajtimeve estetike. Për shkak të rëndësisë së veçantë të estetikës në stomatologjinë moderne klinike, pritjet e larta të pacientëve në lidhje me këtë çështje, dhe kërkimin e kufizuar edhe të publikuar shkencor për të ngjyrosur zirkonin janë të nevojshme kërkime më të plota në këtë fushë. Njohja e ngjyrosësve është thelbësore për ti bërë punimet e zirkonit sa më natyrale. Likidet ngjyrosëse janë me bazë uji, pa përmbajtje acidi dhe aplikohen vetëm me furçë. Ka nuanca të ndryshme të këtyre ngjyrosësve për të përfituar efektin e dëshiruar duke siguruar një mbushje intensive të ngjyrës që depërton thellë në zirkon.

Qëllimi: Të sigurojë prova shkencore që tregojnë rëndësinë dhe efektet e ngjyrës në kurorën full zirkon.

Materiali dhe metoda: Kërkimi është kryer në Medline dhe PubMed duke përdorur fjalët e mëposhtme kyçe; kurorë qeramike, teknikë të thellë dhe furçim, teknologji, zirkon. Vetëm materialet e botuara në anglisht në dhjetë vitet e fundit, janë marrë në konsideratë. Për këtë studim janë mbledhur të dhëna edhe nga trajnimet që studentët laborantë dentarë të Universitetit Aldent kanë ndjekur me firmën prodhuese Yeti-Gebdi Dental, Engen Gjermani.

Rezultate dhe konkluzione: Lloji i teknikës së përdorur në ngjyrosjen e kurorës full zirkon ka ndikim në ngjyrën përfundimtare të këtij punimi. Prandaj rekomandohet që teknika e pasqyruar në këtë studim të merret parasysh si një nga faktorët më influencues në ngjyrën përfundimtare të kurorës.

Gingiviti hipertrofik si pasojë e pranisë së kaviteve dhe mbushjeve jo korrekte (rast klinik)

ARJONA PARLLAKU*; **ERISA MUCA**; **HAMDIE LLESHI**; **DR. NINETA FINO**; **DR. ORGES SIMEON**
Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Gingiviti hipertrofik i njohur ndryshe si gingivitis hiperplastik i referohet inflamacionit kronik të gingivave të stimuluar nga faktorët e ndryshëm etiologjikë lokal të pranishëm në kavitetin oral. Këta faktorë mund të jenë: pllaka bakteriale e papastruar, gurëzat, mbushjet e varura, kavitetet e ndryshme karioze që çojnë në grumbullimin e mbeturinave ushqimore, trajtimet ortodontike etj. Në këtë rast klinik, faktorët kryesorë etiologjikë janë përkatësisht mbushjet jo korrekte dhe prania e kaviteve duke bërë të mundur grumbullim të places bakteriale dhe si rrjedhojë kemi gingivit hipertrofik.

Qëllimi: Evidentimi i gingivitit hipertrofik si pasojë e pranisë së kaviteve dhe mbushjeve jo korrekte dhe trajtimi i tij në një rast klinik.

Materiali dhe metoda: Për këtë punim u mor në shqyrtim një rast klinik. Pacientja me inicialet H.K moshë 20 vjeç, u paraqit në Universitetin Aldent me gingivit hipertrofik të lokalizuar në regjionin mandibular majtas. U bënë ekzaminimet e nevojshme klinike dhe radiologjike ku u vërejt edeme, hiperemi dhe hipertrofi e gingivave. Fillimisht pacientja u trajtua me një kyretim të thellë gingivar, më pas u trajtuan dhëmbët (36, 37) nga ana endodontike dhe u rikonstruktuan me mbushje korrekte, duke krijuar pikën e kontaktit dhe puthitjen marginale.

Konkluzione: Trajtimi i gingivitit hipertrofik u realizua me sukses. Gingivës iu rikthye forma, ngjyra dhe funksioni normal.

Fjalë kyçe: gingivit hipertrofik, inflamacion, kyretim, mbushje e varur, pllakë bakteriale.

Postura ergonomike e studentëve laborant dentar gjatë punës, lidhja midis njohurive teorike dhe praktikës

**DONATELA BENDAJ; BJANKA COMA; EMILJANO VENGO; KRISTINA PERPALAJ;
MSC AJOLA NASTI**

Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent

Hyrje: Njohuritë teorike mbi ergonominë si dhe zbatimi i tyre në praktikë janë shumë të rëndësishme për të parandaluar çrregullimet muskuloskeletale.

Qëllimi: Të krijojmë një lidhje midis njohurive teorike të posturës ergonomike dhe zbatimit në praktikë nga studentët laborant dentar, si dhe midis njohurive teorike që zotërojnë studentët dhe vetëvlerësimi i posturës së tyre në praktikë.

Materiali dhe Metoda: 60 studentë laborant dentar të Universitetit Aldent u zgjodhën në mënyrë rastësore. Studentët iu përgjigjën një pyetësori mbi posturën ergonomike (pikëzimi 0-10). Për të analizuar zbatimin praktik të qëndrimit në punë dhe vetëvlerësimin studentët u fotografuan në momentin që ata po kryenin procese pune në laborator. Për të analizuar zbatimin praktik çdo procedurë është vlerësuar nga grupi i punës, duke u vlerësuar me pikë (0-10). Për vetëvlerësimin, studentët pasi panë fotografitë e tyre vendosën pikët (0-10). Njohuritë teorike si dhe vetëvlerësimi në praktikë u vlerësuan nga hulumtuesi (grupi i punës).

Rezultate: Korrelacioni midis njohurive teorike dhe praktike, duke përfshirë edhe vetëvlerësimin u analizuan duke përdorur koeficientin e Pearson(r). Nuk kishte një korrelacion midis njohurive teorike dhe aplikimit praktik, po ashtu midis njohurive teorike që studentët kishin dhe vetëvlerësimin që ata kishin shënuar.

Konkluzione: Njohuritë teorike të studentëve në ergonomi ishin më të mëdha sesa zbatimi praktik i tyre duke përfshirë edhe vetëvlerësimin.

Fjalë kyçe: ergonomi, probleme muskuloskeletale, shëndeti profesional, studentë laborant dentar.

Një alternativë trajtimi në mbindjeshmërinë e zmallit me preparatin e tiefenfluoridit

SONJA MUÇA; ELENA GAVOJ; LIVIA TAFI; DENADA BUCI; GLEDA DHIMA; ADELINA JAKUPI; ANTEA IRVA ZILEXHIU; ETEVA DROBONIKU; AIDA METO

Departamenti i Dentiŝtrisë Konservative, Fakulteti i Mjekësisë Dentare

Hyrje: Procesi i remineralizimit është i rëndësishëm jo vetëm për luftën ndaj kariesit, por gjithashtu dhe për të shmangur fenomenin e hipersensitivitetit. Mbindjeshmëria lidhet me rritjen e sensitivitetit të indeve dentare nga veprimi i faktorëve mekanik, termik dhe kimik. Ajo mund të shfaqet si pasojë e konsumit të zmallit, ekspozimit të rrënjëve, kariesit apo krisjeve të tij. Manifestimi kryesor i mbindjeshmërisë është dhimbja që vjen si përgjigje ndaj të ëmblave, të thartave, të ftohtave, të ngrohtave, të kripurave, ndaj ajrit apo edhe gjatë përtypjes.

Qëllimi: Të tregojmë rezultatet klinike të trajtimit të mbindjeshmërisë së zmallit në defektet jo-kariogjenike.

Materiali dhe metoda: U trajtuan 30 pacientë, 21 femra dhe 9 meshkuj, të moshës 19-45 vjeçare të diagnostikuar me mbindjeshmëri të zmallit. Shenjat kryesore ishin ndjeshmëria ndaj të ftohtit, të ëmblave, gjatë përtypjes si dhe nga çdo agjent fizik dhe kimik. Ndjeshmëria u mat me anën e aparatit të test-metrit dhe u vlerësua në mK. 15 pacientë u trajtuan në 2-3 seanca me dy solucionet e Tiefenfluoridit, në një interval kohor prej 7 ditësh. 15 të tjerët (si grup kontrolli) u trajtuan në 7 seanca me anën e xhel fluorit tradicional. Ecuria e mbindjeshmërisë tek këto pacientë u ndoq në një hark kohor deri në 6 muaj.

Rezultate: Në të gjitha rastet e trajtuara me Tiefenfluorid, u morën rezultate mjaft premtuese në krahasim me mjekimin tradicional me xhelin fluorik. Që në seancën e parë u vu re një ulje e mbindjeshmërisë që e konstatuam me anën e test-metrit.

Konkluzione: Nga analiza e rasteve tona, doli se preparati i Tiefenfluoridit dha rezultate më të qëndrueshme dhe më të efektshme në krahasim me xhelin fluorik tradicional.

Fjalë kyçe: mbindjeshmëri e zmallit, test-metër, tiefenfluorid, xhel fluorik.

Shumëllojshmëria e pastave të dhëmbëve në Shqipëri dhe përputhshmëria me efektivitetin e tyre ndaj indeve të forta dhe të buta të dhëmbëve tek pacientët adult

ELSENA MATAJ; DITMIR KOPANI; INA GJEÇI; IVA VATA; MARSELA KALACI; MARINELA NDOJ; ILDA DOGJANI; JENA FERIZOLLI; AIDA METO

Departamenti i Dentiŝtrisë Konservative, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Tiranë

Hyrje: Pastat e dhëmbëve janë produkte të përditshme për higjienën orale. Përdoren për largimin e pllakës bakteriale, parandalimin e kariesit, shëndetin e indeve të buta, zbardhjen e dhëmbëve, hipersensitivitetin dentinar. Në treg qarkullon një gamë e madhe pastash të prodhuara nga firma të ndryshme. Këto pasta shiten nëpër supermarkete dhe farmaci në Shqipëri. A ekziston në të vërtetë një dallim nëpërmjet pastave të ndryshme të dhëmbëve? Është ndonjëra realisht më superiore ndaj tjetrës?

Qëllimi: Të japim mendime për zgjedhjen e pastës sipas statusit oral të pacientit duke u bazuar në evidencat shkencore të autorëve të ndryshëm në literaturë.

Materiali dhe metoda: Morëm në studim pastat më të përdorshme në tregun shqiptar. Këto pasta i klasifikuam në dy grupe të mëdha. Në grupin e parë pastat farmaceutike i ndamë në tre nëngrupe: a-pastat me efekt mjekues, b-pastat herbale dhe c-pastat zbardhuese. Në grupin e dytë klasifikuam pastat e shitura nëpër supermarkete, të cilat po ashtu i ndamë në tre nëngrupe: a-pastat e përgjithshme, b-pastat herbale, c-pastat zbardhuese. Elementët përbërës u analizuan duke bërë krahasimet midis këtyre pastave të disponueshme për të parë efikasitetin e tyre. Këto u hodhën në tabelat dhe grafikët përkatës për secilin grup.

Rezultate: Nga analiza e përbërësve të këtyre pastave, vlerësuam cilësitë e çdo ingrediendi. U vrojtuan efektet e pastave farmaceutike me përbërës profilaktik duke u mbështetur në literaturën e huaj.

Konkluzione: Pastat me efekte pozitive për moshat adulte janë ato me përmbajtje fluorike dhe chlorhexidine. Ndërsa, pastat e tjera janë ato, të cilat përmbajnë elementë zbardhues dhe dezinfektues për strukturën dhëmbore.

Fjalë kyçe: ingredientë, literaturë, klasifikim, pastë dhëmbësh, strukturë dhëmbore.

